a) Kur shërbimi i ngjashëm është realizuar me institucione shtetërore, Operatori ekonomik do ta vërtetojë duke paraqitur kontratën e nënshkruar me institucionin, të shoqëruar detyrimisht me situacionet për shërbimet e kryera dhe vërtetimin e lëshuar nga Institucioni shtetëror për realizimin e plote dhe te suksesshëm të kesaj kontrate, ku të jetë e përcaktuar kohëzgjatja e shërbimit, vlera e shërbimit të realizuar.
b) Kur shërbimi i ngjashëm është realizuar me subjekte private, Operatori ekonomik do ta vërtetojë këtë shërbim duke paraqitur faturat tatimore perkatese të shitjes (*ku te shprehen qarte datat,shumat dhe shërbimet e realizuara).*

c.Eksperiencë në Projektim

Operatori ekonomik ose bashkimi I operatorëve ekonomikë duhet të paraqesi si më poshtë:

a. Shërbime të ngjashme të realizuara gjatë tre viteve të fundit të aktivitetit të operatorit ekonomik, në vlerë jo me te vogel se 2**0%** e e vlerës së përllogaritur të shërbimeve të parashikuara në project, dhe perkatesisht 6.182.501 (gjashtëmilion e njëqind e tetëdhjetë e dy mijë e pesëqind e një) leke.

Kur kontratat jane te realizuara me institucione shteterore ofertuesi duhet te paraqese kontraten e lidhur me Institucionin te shoqeruar me vertetimet nga institucioni me te cilin jane nenshkruar keto kontrata mbi realizimin me sukses te tyre, ku të shënohet data, vlera, dhe sherbimet e realizuara.

Kur kontratat jane te realizuara me subjekte private ofertuesi duhet te paraqese faturat tatimore te shitjes (ku te shprehen qarte datat, shumat, dhe sherbimet e realizuara, te firmosura dhe te vulosura nga te dy palet).

d. **Eksperiencë në Furnizimin dhe vendosjen e mobiljeve , orendi dhe paisjeve laboratorike**

Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme me objektin e prokurimit, të kryera gjatë tre viteve të fundit, me një vlerë jo më e vogël se 20% e vlerës së përllogaritur të eksperinces të parashikuara në project ose **24.903.006** (njëzetë e katër milion e nëntëqind e tre mijë e gjashtë tre) lekë pa TVSH dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit.

Kur kontratat jane te realizuara me institucione shteterore ofertuesi duhet te paraqese kontraten e lidhur me Institucionin te shoqeruar me vertetimet nga institucioni me te cilin jane nenshkruar

keto kontrata mbi realizimin me sukses te tyre, ku të shënohet data, vlera, dhe sherbimet e realizuara.

Kur kontratat jane te realizuara me subjekte private ofertuesi duhet te paraqese faturat tatimore te shitjes (ku te shprehen qarte datat, shumat, dhe sherbimet e realizuara, te firmosura dhe te vulosura nga te dy palet).

1. **Liçensa profesionale lidhur me shërbimet objekt i kontratës**:

    a. **Liçensa profesionale të shoqërisë (e vlefshme) për projektim (leshuar nga MZHUT) ku të përfshihen kategorite:**

2/a (Projektim arkitektonik për objekte civile - industriale – turistike-vepra arti në infrastrukturë.)

2/b (Projektim arkitektonik për objekte sportive)

2/d (Projektim peisazhi,sistemim siperfaqe të gjelberta,lulishte e parqe)

3/a(Objekte civile - industriale – turistike prej murature e skelet beton arme deri në 5 kate.)

3/c(Objekte me shkallë të lartë vështirësie Beton arme – metalike – 2. troje dhe shpate me qëndrueshmëri të ulët.)

4/a(Instalime hidrosanitare.)

4/b(Instalime termoteknik – ventilimi - kondicionimi.

4/c(Linja e rrjeta elektrike – telefonike – radiotelefoni – citofoni –sistem alarmi – televiziv etj, për objekte civile, industriale, turistike)

6/a(Rrugë lokale, rrugë urbane dytësore dhe rrugë interurbane dytësore.)

8/a(Bazamente gjeodezike – rivelime në të gjitha shkallët)

8/b(Projektim fotogrametrik – hartografik - topografik.)

9/a(Studim/Vlerësim gjeollogo inxhinierik i truallit për objekte civile – ekonomike deri 5 kate.)

10/c(Impiante të prodhimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike – diellore – era etj.)

10/e (Kabina elektrike të rrjetit shpërndarës – linja të tensionit të ulët – të mesëm.)

11/a(Sinjalistikë në rrugë lokale, rrugë urbane dytësore dhe rrugë interurbane dytësore)

Sqarim: Për licencat e lëshuara pas hyrjes në fuqi të Vendimit nr.943, datë 28.12.2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.759, datë 12.11.2014, të Këshillit të Ministrave ‘Për licencimin professional të individëve dhe personave juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë **Liçensa profesionale të shoqërisë (e vlefshme) për projektim (leshuar nga MZHUT)***, e vlefshme, ku të përfshihen kategoritë e mësipërme me ndryshimet përkatëse në emërtesë.*

2. **Operatori ekonomik duhet te paraqese Licencat profesionale te stafit kryesor përgjegjës për zbatimin e kontratës ne kategorite si me poshte shenuar, shoqeruar patjeter me cv, kontratat individuale te punes (të vlefshme), si dhe stafi i mëposhtëm duhet të ketë eksperiencë të paktën 5 vite në sektoret përkatës**

- *Projektues Arkitekt* me Kat 2/a/b/d (2/a (Projektim arkitektonik për objekte civile - industriale – turistike-vepra arti në infrastructure, projektim arkitektonik për objekte sportive, projektim peisazhi,sistemim siperfaqe të gjelberta,lulishte e parqe)
- *Projektues Konstruktor* me Kat 3/a/c (Objekte civile - industriale – turistike prej murature e skelet beton arme deri në 5 kate , Objekte me shkallë të lartë vështirësie Beton arme – metalike – 2. troje dhe shpate me qëndrueshmëri të ulët.)
- *Projektues Instalator* me Kat 4/a/b/c((Instalime hidrosanitare, Instalime termoteknik – ventilimi – kondicionimi, Linja e rrjeta elektrike – telefonike – radiotelefoni – citofoni – sistem alarmi – televiziv etj, për objekte civile, industriale, turistike)
- *Projektues Rrugë-Hekurudha* me Kat 6/a. (Rrugë lokale, rrugë urbane dytësore dhe rrugë interurbane dytësore.)
- *Projektues Gjeodet* me Kat 8/a/b (Bazamente gjeodezike – rivelime në të gjitha shkallët, Projektim fotogrametrik – hartografik - topografik).
- *Projektues gjeollogo inxhinierik –hidrogjeologjiko* me Kat 9/a (Studim/Vlerësim gjeollogo inxhinierik i truallit për objekte civile – ekonomike deri 5 kate)
- *Projektues i Impianteve të prodhimit dhe shpërndarjes së energjisë* me Kat. 10/c/e ((Impiante të prodhimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike – diellore – era etj, Kabina elektrike të rrjetit shpërndarës – linja të tensionit të ulët – të mesëm.)
- *Projektues të sinjalizimit rrugor* me Kat11/a (Sinjalistikë në rrugë lokale, rrugë urbane dytësore dhe rrugë interurbane dytësore)

- ***Një projektues nuk duhet të jetë i angazhuar njëkohësisht në stafin e dy shoqërive që marrin pjesë në procedurën e koncesionit /PPP.***

2.4 Liçensa profesionale, lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës:

a. Liçenca e shoqërisë e vlefshme për kategoritë e mëposhtme:

- *NP – 1 A (Punime gërmimi në tokë)*
- *N.P – 2F (Ndërtime civile dhe industriale*.)
- NP-3 C (Rindërtim dhe Mirëmbajtje e ndërtesave Civile dhe Industriale)
- *NP- 11A (Ndërtime për N/Stacionet, kabinat e transformatorëve linja të tensionit të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë)*
- *NP- 12A (Punime te inxhinierise se Mjedisit)*

NS1-A(Punime per prishjen e ndertimeve)

- *NS – 2C (Impiante hidro – sanitare, kuzhina, lavanteri, mirembajtja e tyre)*
- *NS-3A(Impiante ngritëse transportuese)*
- *NS – 4E (Punime rifiniture te muratures dhe te lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture te natyres teknike ndertuese)*
- *NS-8A(Konstruksione betoni arme të parafabrikuar, struktura metalike dhe druri)*
- *NS-9C(Punime te posacme strukturore)*
- *NS-12 A (Impiante teknologjike,termike dhe kondicionimi)*
- *NS-13A(Implementimi i linjave telefonike dhe sistemeve te telekomunikacionit)*
- *NS- 14A (Impiante te brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni, TV, etj)*
- *NS-18A (Punime Topogjeodezike).*
- *NS-19A(Sisteme izoluese të zhurmës për projektet infrastrukturore)*

- sipas modelit të lëshuar nga MPPT;

*3. K*andidati ofertues duhet të përcaktoje me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) katër drejtuesa teknikë të punimeve në objekt (drejtuesit teknik duhet te kenë secili më vete mbi 5 (njëzetë) vjet eksperiencë pune e pasqyruar kjo në CV perkatëse), te perfshire ne licensen e shoqerise dhe të deklaroje se do të jenë të pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objektet përkatës, shoqeruar me dokumentacionin e meposhtem:

i. CV perkatese

ii. Kontrate pune e vlefshme (përkatëse)

iii. Diplome

4. Një punësim mesatar i të paktën 250 (dyqind e pesedhjete) personave, për periudhën Tetor 2015 - Tetor2017 të vërtetuar me;

4.1 Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet shoqerore ose Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj; per periudhen Tetor 2015 - Tetor2017

4.2 List pagesat e punonjesve sipas formatit qe kerkohet nga legjislacioni ne fuqi per periudhen Tetor 2015 - Tetor2017 shoqëruar me formularet e deklarimit te pagesave për sigurimet shoqërore dhe shendetesore.

5. Operatorët ekonomike pjesëmarrës duhet te kenë në stafin e tyre dhe te figurojne në listpagesat e shoqërisë për te pakten gjashte muajt e fundit, vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplomë, CV.

- Arkitekt 2(dy)
- Inxhinier Ndertimi 2(dy)
- Inxhinier Hidroteknik 1(një)
- Inxhinier Topograf/Gjeodet 1(një)
- Inxhinier Mjedisi 1(një)
- Inxhinier Mekanik 1(një)
- Inxhinier Gjeolog 1(një)
- Inxhinier Elektrik. 1(një)

5.1 Të ketë në stafin e punonjesve te pasqyruar ne list pagesat e shoqërisë për gjashtë muajt e fundit të pakten **40 (dyzetë) punonjës** të pajisur me deshmi kualifikimi te sigurimit teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente me të, ku nga keta te jene te pakten:

- **Grupi I- 10 (dhjetë) punonjës**
- **Grupi II-24 (njëzetë e kater) punonjës**
- **Grupi III- 2(dy) punonjës**
- **Grupi IV-2 (dy) punonjës**
- **Grupi V- 2 (dy) punonjës**
- **(Per punonjesit e siperpermendur te paraqiten deshmite perkatese te kualifikimit te sigurimit teknik)**
- *Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar minimalisht 4(katër) punonjës manovratorë të mjeteve të rënda. Për këto punonjës duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme, dëshmite e drejtimit (të vlefshme), lëshuar nga institucionet përkatëse si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për gjashtë muajt e fundit, për manovratorët duhet të paraqesin gjithashtu dhe dëshmite e drejtimit (të vlefshme) nga të cilat dy dëshmi të jenë për automakinistë dhe dy të tjerat eskavatoristë, lëshuar nga institucionet përkatëse*)

- Te kete ne staf te punësuar dhe te figurojne ne listpagesat e shoqerise:
- a. Inxhinier – Auditues energjie 1 (një)person (të pajisur me “Certifikate per auditimin e energjise)
- b. ekspert zjarrfikes te certifikua 1(një) person
- (Per inxhinierin e eficenses se energjise duhet te kete keto dokumenta provues: Kontrata e punes (e vlefshme per te pakten periudhen e parashikuar te ndertimit), Certifikata (Dip) per eficensen e energjise, Diploma, për ekspertin zjarrfikës çertifikata e ekspertit zjarrëfikës si dhe Kontrata e punes (e vlefshme per te pakten periudhen e parashikuar te ndertimit).

- Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë 1(një) mjek ndërmarrjeje, kjo të vërtetohet me paraqitjen Urdhër mjeku, diplomë, CV, librezë pune dhe Kontratës së Punës së mjekut me operatorin ekonomik e vlefshme për periudhën e ndërtimit dhe të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë për të paktën gjashtë muajt e fundit.

6. Shoqeria duhet te paraqesë Certifikaten **ISO 9001- 2008**(Sistemi I menaxhimit të cilësisë) (e vlefshme).

7.Shoqeria duhet te paraqesë Certifikate **ISO 14001-2004** (Sistemi I menaxhimit të mjedisit)(e vlefshme).

8.Shoqëria duhet të paraqesë certifikatë **OHSAS 18001-2007** (Sistemi I menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë)(e vlefshme)

9.Shoqëria duhet të paraqesë certifikatë **PAS 99-2012** (Sistem I integruara I menaxhimit)(e vlefshme)

11.Shoqëria duhet të paraqesë certifikatë **ISO 27001-2013** (Sistemi I menaxhimit të sigurisë së informacionit) (e vlefshme)

12. Shoqëria duhet të paraqesë certifikatë **ISO 50001-2011** (Sistem I menaxhimit të energjisë) (e vlefshme)

13. Shoqëria duhet të paraqesë certifikatë **ISO EN 3843-2-2006** (Menaxhimi I cilësisënë proces të punimeve me Saldim) (e vlefshme)

14.Operatorët Ekonomik pjesmarrës në këtë proçedurë koncesioni/PPP duhet të paraqesin çertifikatat e produktit konform standarteve europane për artikujt respektivë si më poshtë:

1.Tavolinë nxënësi(banke nxenesi) cikli I ulët , I mesëm EN 1729-1:2006, EN 1729-2:2006

2.Karrike nxënësi cikëli I ulët, I mesëm dhe I lartë EN 1729-1:2006, EN 1729-2:2006

3.Dollap/Etazher EN 14073-3:2004:

4.Karrike mësuesi EN 1335-1:2000, EN 1335-2:2009, EN 1335-3:2009

5.Tabelë shkrimi(dërrasë e zezë) EN 71-3:2014

15.Çertifikatat kërkohen të jenë të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit, si dhe të jenë të shoqëruara me përkthim në shqip,të noterizuara në formën e kërkuar për operatorët ekonomike shqiptarë. Ne rastet e bashkimit te operatoreve ekonomikë mjafton njëri prej anëtarëve të bashkimit të disponojë certifikatat e mësipërme.

16. Operatorët ekonomike pjesëmarrës duhet te kenë në stafin e tyre të paktën 1 (një) inxhinier druri të vërtetuar me diplomë, CV dhe kontratë pune (e vlefshme per te pakten periudhen e parashikuar te investimit) si dhe të rezultojë në listpagesa per gjashte muajt e fundit.

17. Subjekti ofertues duhet të deklarojë garancinë e mallrave e cila duhet të jetë jo më pak se një vit.

18. Operatori duhet të ketë staf teknik dhe te figuroje ne listpagesa per gjashte muajt e fundit nje inxhinier telekomunikacioni ose elektronik të punësuar, te vertetuar me:

- CV,
- Kontrate pune,
- Diplomat universitare .

19.Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratë (shtojca 8)

Mjetet	**Sasia**	**Gjendja**
Kamion vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës minimum 15(pesembëdhjetë) ton dhe maksimumii 22(njëzetë e dy) ton për secilin kamion)	*5 copë*	*Pronësi ose me qera*
Fadrome me goma	*2 copë*	*Pronësi ose me qera*
Autovinç me kosh	*1 copë*	*Pronësi ose me qera*
MotoGjenerator	*3 copë*	*Pronësi ose me qera*
Eskavator me goma 0.25 m3	*2 copë*	*Pronësi ose me qera*
Kamioçinë kapaciteti mbajtës për secilën kamionçinë minimum 2 ton dhe maksimumi 5 ton	*4 copë*	*Pronësi ose me qera*
Autobetoniere	*3 copë*	*Pronësi ose me qera*
Fadromë e vogël/Minifadrome	*2 copë*	*Pronësi ose me qera*
Kamion vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës minimum 3.5 (tre pike pese) ton dhe maksimumi 7 (shtatë) ton per secilin kamion)	*4 cope*	*Pronësi ose me qera*
Autobot uji	*3 copë*	*Pronësi ose me qera*
Gjenerator	*3 copë*	*Pronësi ose me qera*
Minieskavator	*2 copë*	*Pronësi ose me qera*
Autopompë betoni	*2 copë*	*Pronësi ose me qera*
Frezë Asfalti	*1 copë*	*Pronësi ose me qera*
Aparat Topografik Stacion Total për punimet topogjeodezike	*2 copë*	*Pronësi ose me qera*
Kamion me vinxh	*2 copë*	*Pronësi ose me qera*
Betonforma	*1500 m2*	*Pronësi ose me qera*
Matrapik	*4 cope*	*Pronësi ose me qera*
Vibrator	*3 cope*	*Pronësi ose me qera*
Depozite uji (500L secila)	*4 cope*	*Pronësi ose me qera*

Skela metalike (forme H) te kompletuara me parapet mbrojtes dhe rrjete mbrojtese per punime ne fasade	*1500 m2*	*Pronësi ose me qera*
Prerese asfalti	*1 cope*	*Pronësi ose me qera*
Aparat Saldimi	*2 cope*	*Pronësi ose me qera*
Autobot Uji	*1 cope*	*Pronësi ose me qera*
Fabrike Prodhim Betoni	1 cope	Pronësi ose me qera
Rrul Gome Cilinder per ngjeshje me Vibrim	*2 cope*	*Pronësi ose me qera*
Rrul Cilinder Cilinder per ngjeshje me Vibrim	*1 cope*	*Pronësi ose me qera*
Vinc kulle me lartesi min 30 ml me peshembajtje te pakten 850 kg ne 35 ml distance	*2 copë*	*Pronësi ose me qera*
Asfaltoshtruese	*1 copë*	*Pronësi ose me qera*
Autobitumatriçe	*1 copë*	*Pronësi ose me qera*
Tokmak per ngjeshje dheu (Motor me karburant ose elektrik)	*1 cope*	*Pronësi ose me qera*
Pompe suvatimi	*1 copë*	*Pronësi ose me qera*

Të paraqiten mjete dhe pajisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit si më poshtë:

- Kokore minimumi 100 copë
- Rripa lidhës sigurimi për punime në lartësi minimumi 10 copë
- Fikëse zjarri të lëvizshme me kapacitet 5-7 litra secila minimumi 10 copë
- Prozhektorë ndriçimi natën minimumi 10copë
- Komplet i ndimës së shpejtë minimumi 10 copë
- Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi 20 copë

a) *Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit (te vlefshme), dhe per mjetet e siguruara me qera, dokumenti qe verteton regjistrimin e tij plus certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit,(te vlefshme) duhet te shoqerohet me kontraten perkatese te qerase/furnizimit, e vlefshme per te gjithe periudhen e realizimit te kontrates objekt i ketij prokurimi. Në rastin e mjeteve te tjera duhet te jene aktet e çdoganimit ose faturat tatimore te blerjes.*

b) *Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre.*

c) *Për mjetet e marra me qera të të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj.*

Per fabriken e prodhimit te betonit, ne rast se eshte ne pronesi duhet te paraqitet akti i pronesise i shoqeruar me leje mjedisore leshuar nga QKL. Ne rast se operatori ekonomik ka kontrate qeraje duhet te paraqitet akti i pronesise se qiradhensit shoqeruar me lejen mjedisore leshuar nga QKL.Kontrata e qerase duhet te jete e noterizuar, ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj.

d) *Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.*

e) *Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruara sipas shtojcës Nr. 8. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese).*

f) *Makineritë e mësipërme nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk jane te deklaruara ne procedurat te shpallura fitues nga autoriteti kontraktor, Bashkia Tirane. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese ku te deklarohet dhe vendndodhja e mjeteve ne pronesi ose me qera me qellim verifikimi).*

g) *(opsion) Do të organizohet një vizitë në kantier deri në date 27.12.2017 në mënyrë të tillë që Operatorët Ekonomikë të mund të familiarizohen me kushtet lokale. Operatori i interesuar Ekonomik duhet të konfirmojë paraprakisht me shkrim synimin e tij për të marrë pjesë në këtë vizitë. Gjatë vizitës do t’u jepen informacione shtesë e shpjegime. Të gjitha kostot e Operatorëve Ekonomikë që lidhen me vizitën në kantier duhet të mbulohen nga vetë ata. Pa paragjykuar sa më sipër, dhe me kostot e risqet e veta, një operator ekonomik mund t’a vizitojë në çdo kohë vendndodhjen e kantierit, nëse një gjë e tillë është e mundur.*

Për të organizuar një vizitë në kantier, ju lutem drejtoni nje shkrese prane Drejtorise se Prokurimit Bashkia Tiranë.

Kujdes: Operatorët Ekonomikë pjesmarrës në procedurën koncesionare /PPP duhet ti ofrojnë Autoritetit Kontraktor tre shoqëri supervizioni si dhe tre kolaudator (person fizik ose person juridik), në rastin e shpalljes fitues në këtë procedurë Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën për të përzgjedhur kush do të mbikqyrë punimet si dhe do të kolaudojë objektet. Për shoqëritë e supervizionit Operatorët Ekonomikë do të paraqesin dokumentat si më poshtë:

Operatori ekonomik duhet të paraqesë **Liçensë profesionale** për **“Mbikqyrje dhe Kolaudim Punimesh Zbatimi”**, e vlefshme, ku të përfshihen kategoritë e mëposhtme, (sipas modelit të lëshuar nga MPPT) ose Kontrata bashkëpunimi të vlefshme me shoqëri ose inxhinierë të liçensuar për këto kategori:

- *NP – 1 (Punime gërmimi në tokë)*
- *N.P – 2 (Ndërtime civile dhe industriale.*

- NP-3 (Rindërtim dhe Mirëmbajtje e ndërtesave Civile dhe Industriale)
- *NP- 11 (Ndërtime për N/Stacionet, kabinat e transformatorëve linja të tensionit të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë)*
- *NP- 12(Punime te inxhinierise se Mjedisit)*

NS-1(Punime per prishjen e ndertimeve)

- *NS - 2(Impiante hidro – sanitare, kuzhina, lavanteri, mirembajtja e tyre)*
- *NS-3(Impiante ngritëse transportuese)*
- *NS – 4(Punime rifiniture te muratures dhe te lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture te natyres teknike ndertuese)*
- *NS-8(Konstruksione betoni arme të parafabrikuar, struktura metalike dhe druri)*
- *NS-9(Punime te posacme strukturore)*
- *NS-12 (Impiante teknologjike,termike dhe kondicionimi)*
- *NS-13A(Implementimi i linjave telefonike dhe sistemeve te telekomunikacionit)*
- *NS- 14 (Impiante te brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni, TV, etj)*
- *NS-18 (Punime Topogjeodezike).*
- *NS-19(Sisteme izoluese të zhurmës për projektet infrastrukturore)*

Sqarim: Për licencat e lëshuara pas hyrjes në fuqi të Vendimit nr.943, datë 28.12.2016 "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.759, datë 12.11.2014, të Këshillit të Ministrave 'Për licencimin professional të individëve dhe personave juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim", Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë Liçensë profesionale për "Mbikqyrje dhe Kolaudim Punimesh Zbatimi", e vlefshme, ku të përfshihen kategoritë e mësipërme me ndryshimet përkatëse në emërtesë.

Si dhe

e. **Eksperience në mbikqyrje punimesh**

Shërbime të ngjashme me objektin e prokurimit me vlerë 40% e vlerës së përllogaritur të shërbimeve të parashikuara në project dhe konkretisht: **5.088.115** (pesëmilion e tetëdhjetë e tetë mijë e njëqind e pesëmbëdhjetë) lekë pa TVSH, të realizuara gjatë tri viteve të fundit.

Për të vërtetuar këtë Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

c) Kur shërbimi i ngjashëm është realizuar me institucione shtetërore, Operatori ekonomik do ta vërtetojë duke paraqitur kontratën e nënshkruar me institucionin, të shoqëruar detyrimisht me situacionet për shërbimet e kryera dhe vërtetimin e lëshuar nga

Institucioni shtetëror për realizimin e plote dhe te suksesshëm të kesaj kontrate, ku të jetë e përcaktuar kohëzgjatja e shërbimit, vlera e shërbimit të realizuar.

d) Kur shërbimi i ngjashëm është realizuar me subjekte private, Operatori ekonomik do ta vërtetojë këtë shërbim duke paraqitur faturat tatimore perkatese të shitjes (*ku te shprehen qarte datat,shumat dhe shërbimet e realizuara).*

(Për Operatorët e Huaj , dokumentacioni duhet të paraqitet në formën e kërkuar në përputhje me legjislacionin e Republikës së Shqipërisë në rastin e moslëshimit të dokumentave të mësipërm në vendin e origjinës te përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor në Kriteret e Përgjithshme të Kualifikimit si dhe në Kriteret e Veçanta të Kualifikimitnë, kriteret e mësipërme të rregullohen sipas legjislacionit në vendin e origjinës pra operatori ekonomik i huaj mund të paraqesë dokumenta ekuivalentë me to ose deklaratë me shkrim)Në rastin e paraqitjes së ofertës apo dokumentacionit të parashikuar në Kriteret e Vecanta të Kualifikimit në monedhë të ndryshme nga ajo e aplikuar në Republikën e Shqipërisë , operatorët Ekonomikë do ti referohen kursit të këmbimit valutor të deklaruar nga Banka e Shqipërisë ditën e publikimit së procedurësnë sistemin elektronik te app-së.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Shtojca 10

[*Shtojcë për t’u plotësuar nga Operatori Ekonomik*]

DEKLARATË MBI GJENDJEN GJYQËSORE

Deklaratë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën koncensionit/ppp që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktues _____ me objekt _____me fond limit _____.

Unë i nënshkruari _____me cilësinë_____të operatorit ekonomik _____ deklaroj se:

- Operatori ekonomik _____ nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP,
- Operatori ekonomik _____ nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, që lidhet me aktivitetin profesional.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Përfaqësuesi i ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 11

[*Shtojce per tu plotesuar nga Autoriteti Kontraktor*]

KRITERET E VLERESIMIT

Ofertat do te vleresohen ne baze te kritereve te meposhteme, dhe fitues do te konsiderohet ai ofertues qe ka pike me teper ne baze te kritereve te vleresimit.

Komisioni i Vlersimit te Ofertave do te vleresoje Ofertat Teknike dhe Financiare, ne baze te kritereve te meposhtme:

VLERESIMI I OFERTAVE

Kriteret e vlerësimit janë si më poshtë:

Nr.	**Kriteri**	**Rezultati Maks.**	**Pragu Mininimal/ Rezultati Kalues**
TC1	Ideja e përgjithshme dhe koncepti i projektit	5	1
TC2	Zgjidhja e tipologjisë arkitektonike të shkollave *-plan-vendosja e objektit në terren* *-marëdhënia me kontekstin urban dhe*	10	3

	hapësirën publike *-marrdhënia mes hapësirave të jashtme e të brendshme*		
TC3	Zgjidhja e organizimit të funksioneve të parashikuara *-zgjidhja e ofruar për organizimin funksional* *-zgjidhja planimetrike dhe drita natyrale* *-skema e qarkullimit për personat me aftësi të kufizuar* *-integrimi i kopshtit me shkollën 9 vjecare*	10	3
TC4	Konceptimi i shkollës së qendër komunitare	10	3
TC5	Teknikat inovative në fushën e kursimit të energjisë	5	1
TC6	Materialet e përdorura	10	3
	KRITERET TOTALE TEKNIKE	**50**	
FC1	Oferta ekonomike për projektimin, ndërtimin, mobilimin dhe mbikqyrjen	30	
FC2	Oferta ekonomike për mirëmbajtjen deri në fund të kontratës	5	
FC3	Oferta ekonomike për marzhin e fitimit	15	
	KRITERET TOTALE FINANCIARE	**50**	
	TOTALI	**100**	

KRITERET TEKNIKE

TC1: Ideja e përgjithshme dhe koncepti i projektit – 5 pikë (pragu minimal/rezultat kalues – 1 pikë)

Ofertuesit do të vlerësohen ne bazë të konceptit të projektit të paraqitur dhe tërësinë e ideve që gjenerojnë formën finale të objektit dhe hapësirave përreth tij. Ofertuesit duhet të paraqesin një shtjellim të detajuar nga ideja fillesare deri tek zgjidhja përfundimtare e projektit. Koncepti i projektit do të vlerësohet mbi bazën e marrëdhënies dhe ndërveprimit të pjesës së eksterierit me atë të interierit.

TC2: Zgjidhja e tipologjisë arkitektonike të shkollave – 10 pikë (pragu minimal/rezultat kalues – 3 pikë)

Tipologjia arkitektonike lidhet me shtirjen e objekteve në horizontalitet dhe vertikalitet, dhe ofertat e paraqitura do të vlerësohen duke marrë në konsideratë elementët e mëposhtëm:

-planvendosja në terren e objekteve, duke marrë parasysh orientimin ndaj dritës, hijëzimin aty ku është e nevojshme, organizimin e oborreve dhe terreneve sportive.
-marrëdhënia me kontekstin urban dhe hapësirën publike ku projekt-idetë e paraqitura do të vlerësohen për raportin e arkitekturës së propozuar me ndërtimet ekzistuese në terren si edhe rolin që ajo do të luajë në rivitalizimin e hapësirave publike ekzistuese dhe formësimin e hapësirave të reja -marrëdhënia mes hapësirave të jashtme dhe hapësirave të brendshme ku vlerësimi do të bëhët mbi bazën e zgjidhjes së ofruar për një ndërveprimi sa më të mirë mes funksioneve të brendshme të shkollave (klasat, korridoret, laboratorët etj.) me funksionet e jashtme (oborret, terrenet sportive, hapësirat rekreacionale, etj.)

TC3: Zgjidhja e organizimit të funksioneve të parashikuara – 10 pikë (pragu minimal/rezultat kalues – 3 pikë)

Ofertat do të vlerësohen për organizimin e funksioneve të parashikuara në detyrën e projektimit, duke u bazuar në elementët e mëposhtëm:

-zgjidhja e ofruar për organizmin funksional ku do të vlerësohet skema e organizmit të ambienteve mësimore, klasave, laboratorëve si edhe të gjitha hapësirave mbështetëse
-zgjidhja planimetrike dhe drita natyrale ku do të vlerësohet organizimi i brendshëm krahasuar me diellëzimin, hijëzimin dhe orientimin e hapësirave të brendshme për të minimizuar zhurmat nga ambientet përreth
-skema e qarkullimit për personat me aftësi të kufizuar ku do të vlerësohet skema e aksesit të këtyre personave në ambientet e jashtme dhe të brendshme të shkollës
-*integrimi i kopshtit me shkollën 9 vjecare*

TC4: Konceptimi i shkollës si qendër komunitare – 10 pikë (pragu minimal/rezultat kalues – 3 pikë)

Ofertat e ardhura do të vlerësohen duke pasur si synim polifunksionalitetin e objekteve shkollore. Projekt-idetë do të vlerësohen në lidhje me sa në shërbim të komunitetit do të jenë strukturat pas orarit zyrëtar të mësimit. Projektet duhet të ofrojnë zgjidhje që japin mundësinë që pjesë të caktuara të mjediseve të përdoren nga komuniteti të veçuara nga mjediset mësimore.

TC5: Teknikat inovative në fushën e kursimit të energjisë - 5 pikë (pragu minimal/rezultat kalues – 1 pikë)

Ofertat do të vlerësohen për skemën e propozuar të efiçencës energjitike dhe teknikat e propozuara për kursimin e energjisë, ku do të përfshihen sistemet e ngrohjes, ftohjes e aspirimit si edhe shtresat e propozuara për muret perimetrale, dyshemetë dhe tarracën.

TC6: Materialet e përdorura - 10 pikë (pragu minimal/rezultat kalues – 3 pikë)

Projekt-idetë do të shoqërohen me një preventiv paraprak ku materialet e propozuara për ndërtim do të vlerësohen për cilësinë e tyre, nevojën për mirëmbajtje, jetëgjatësinë, estetikën dhe durueshmërinë ndaj zjarrit dhe agjentëve atmosferikë.

TC: REZULTATI TEKNIK – *maksimumi 50 pikë*

TCi = TC1i + TC2i + TC3i + TC4i +TC5i + TC6i

KRITERET FINANCIARE

FC1: Oferta ekonomike për projektimin, ndërtimin, mobilimin dhe mbikqyrjen– *maksimumi 30 pikë*

Rezultati për ofertën ekonomike për projektimin, ndërtimin, mobilimin, mbikqyrjen dhe oponencën teknike llogaritet si vijon:

FC1i = 30 x C/Cu

Ku:

FC1i = Pikët totale për ofertën ekonomike
C = çmimi I ofertës me te ulet të propozuar
Cu = çmimi I ofertes se rradhes

Ku oferta ekonomike e ardhur tejkalon fondin limit të përcaktuar, oferta do të përjashtohet si jo e përgjegjshme.

FC2: Oferta ekonomike për mirëmbajtjen deri në fund të kontratës – *maksimumi 5 pikë*

Rezultati për ofertën ekonomike për mirëmbajtjen deri në fund të kontratës llogaritet si vijon:

FC2i = 5 x CM/CMu

Ku:

FC2i = Pikët totale për ofertën ekonomike
CM = çmimi I ofertës me te ulet të propozuar
CMu = çmimi I ofertes se rradhes

FC3: Oferta ekonomike për marzhin e fitimit – *maksimumi 15 pikë*

Rezultati për ofertën ekonomike për marzhin e fitimit (maksimumi 6.28%) llogaritet si vijon:

FC3i = 15 x MF/MFu

Ku:

FC3i = Pikët totale për marzhin e fitimit
MF = marzhi i fitimit me I ulet I propozuar
MFu = marzhi i fitimit I radhes I propozuar

FC: REZULTATI FINANCIAR – *maksimumi 50 pikë*

FCi = FC1i + FC2i + FC3i

VLERESIMI I PERGJITHSHEM

Pikët totale = TCi +FCi

Shtojca 12

[*Shtojce per tu plotesuar nga Operatori Ekonomik i Huaj*]

VETEDEKLARIM PËR OFERTUESIT E HUAJ

Per pjesemarrjen ne proceduren per marrjen me koncesion/ppp te “_ ”

Date

Per:[Date]

[*Emri i Ofertuesit /Anetari Kryesues i Bashkimit te Perkohshem]* deklaroj dhe garantoj qe, ne daten e kesaj letre [*Emri i Ofertuesit /Anetari Kryesues i Bashkimit te Perkohshem*] dhe cdo anetar i *Bashkimit te Perkohshem* (kur është rasti)

(a) nuk i eshte nenshtruar procedurave te falimentimit ose likuidimit;

(b) nuk eshte denuar per shkelje penale;

(c) nuk eshte denuar me Vendim te Gjykates se Formes se prere, qe lidhet me aktivitetin profesional;

(d) kapitalet/asetet nuk po vleresohen nga Zyra e Permbarimit apo ekziston një urdhër sekuestroje për to;

(e) ka përmbushur të gjitha detyrimet fiskale;

(f) ka përmbushur të gjitha detyrimet e sigurimeve shoqerore .

Me respekt

Nenshkrimi i Personit te Autorizuar
Emri dhe Pozicioni i Nenshkruesit
Emri i Ofertuesit/Kryesuesit të Bashkimit të Përkohshëm
Adresa

Shtojca 13

(Shtojce per tu plotesuar nga autoriteti kontraktor)

PROJEKTI I ZBATIMIT DHE SPECIFIKIMET TEKNIKE

BASHKIA
TIRANË

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PUNËVE PUBLIKE

DETYRE PROJEKTIMI

PËR REALIZIMIN E STUDIM PROJEKTIMIT:

“Ndërtim i ri i Shkolle Tip2 në Njësinë Administrative Nr.6
(Sheshi 6/3)

- CONTENTS

DETYRE PROJEKTIMI 54

1. TË DHËNA TË PËRGJITHSHME DHE GJENDJA EKZISTUESE E OBJEKTIT 62

2. KËRKESA PROJEKTIMI TË PËRGJITHSHME PËR NDËRTIMIN E SHKOLLËS 73

2.1 Hapësirat kryesore 74

2.1.1 Klasat e mësimit 75

2.1.2 Laboratorët ..... **Error! Bookmark not defined.**

2.1.3 Mobilimi 79

2.1.4 Laboratorët ..... **Error! Bookmark not defined.**

2.1.5 Punëtoritë 86

2.1.6 Dhomat e muzikës dhe të vizatimit ..... **Error! Bookmark not defined.**

2.2 Hapësirat shoqërore 91

2.2.1 Biblioteka 91

2.2.2 Hapësira për shumë qëllime 92

2.2.3 Salla për edukimin fizik 98

2.3 Hapësirat administrative 101

2.3.1 Zyra e drejtorit / Zyra e nëndrejtorit 101

2.3.2 Sekretariati / dhoma për administratën 341

2.3.3 Salla e mësuesve 102

2.3.4 Personeli ndihmës 102

2.4 Hapësirat ndihmëse 103

2.4.1 Ambjentet higjeno-sanitare 103

2.4.2 Kabineti i mjekut 104

2.4.3 Kabineti i psikologut 104

2.5 Ambientet komunikuese, hyrjet, shkallët, korridoret, hollet 105

2.5.1 Korridorët 105

2.5.2 Shkallët 106

2.5.3 Ashensori 106

2.5.4 Holli 106

2.5.5 Depot, kthinat ndihmëse 107

2.5.6 Garderobat ..... **Error! Bookmark not defined.**

3. ORENDITË DHE PAJISJET 114

3.1 Antropometria dhe dimensionet e orendive ..... **Error! Bookmark not defined.**

4. KËRKESA TË VEÇANTA ..... **Error! Bookmark not defined.**

4.1 Projektimi për personat me nevoja të veçanta 140

4.2 Shkolla si Qendër Komunitare 143

4.3 Komoditeti Termik (Temperatura) 144

4.3.1 Përkufizimet dhe terminologjia 144

4.3.2 Përmirësimi i komoditetit termik 145

4.3.3 Kontrolli aktiv i temperaturës 146

4.3.4 Temperatura dhe nivelet e lagështisë ..... **Error! Bookmark not defined.**

4.3.5 Standardi i izolimit 146

4.3.6 Urat termike 147

4.3.7 Kërkesa e vlerave të U(Ë/m²K)(koeficientii transmetimit termik) 148

4.3.8 Dritaret dhe Dyert 148

4.3.9 Kontrolli pasiv i temperaturës 148

4.4 Komoditeti Vizual 151

4.5 Komoditeti Akustik 153

4.6 Ngjyrat dhe përdorimi i tyre 154

4.6.1 Kuptimi i ngjyrave 154

4.6.2 Përdorimi i ngjyrave 155

5. IMPJANISTIKA 156

5.1 Standartet per projektet elektrike ..... **Error! Bookmark not defined.**

5.2 Impjantistika Mekanike ..... **Error! Bookmark not defined.**

5.3 Impjanti i mbrojtjes ndaj zjarrit ..... **Error! Bookmark not defined.**

5.4 Impjanti i furnizimit me ujë sanitar të ftohtë..... 173

5.5 Impjanti i ujit të ngrohtë sanitar ..... **Error! Bookmark not defined.**

5.6 Impjanti i shkarkimit të ujrave të zeza dhe të përdoruraError! Bookmark not defined.

5.7 Impjanti i shkarkimit të ujrave të shiut dhe të ujrave të bardhaError! Bookmark not defined.

5.8 Impjanti i ngrohjes, ventilimit dhe kondicionimit (H.V.A.C)Error! Bookmark not defined.

5.9 Impjanti i mbrojtjes ndaj zjarrit ..... **Error! Bookmark not defined.**

5.9.1 Mbrojtja Pasive..... **Error! Bookmark not defined.**

5.9.2 Mbrojtja Aktive ..... **Error! Bookmark not defined.**

5.9.3 Terma dhe përcaktime grafike të kartelave të sinjalistikës dhe simboleve teknike ..... **Error! Bookmark not defined.**

5.9.4 Terma dhe përcaktime terminologjike të elementeve konstruktive, distancave, rrugëve të shpëtimit, evakuimit të tymrave dhe mjeteve aktive të sinjalizim-dedektimit dhe shuarjes së zjarrit. ..... **Error! Bookmark not defined.**

5.9.5 Klasifikimi i nivelit të rrezikut të zjarrit..... **Error! Bookmark not defined.**

5.9.6 Mjetet portative (bombolat), të shuarjes së zjarrit..... **Error! Bookmark not defined.**

5.9.7 Impjantet me dispositive gjysmë të lëvizshme (hidrantët, naspot) të shuarjes së zjarrit ..... **Error! Bookmark not defined.**

5.9.8 Impjantet me dispozitiv të palëvizshëm automatik (sprinklerat) të shuarjes së zjarrit ..... **Error! Bookmark not defined.**

5.9.9 Centralet e presurizimit dhe rezerva ujore për shuarjen e zjarrit**Error! Bookmark not defined.**

5.9.10 Rrjeti i shpërndarjes, komponentët kryesorë impiantistikë**Error! Bookmark not defined.**

5.9.11 Impianti i kontrollit dhe evakuimit të tymrave ..... **Error! Bookmark not defined.**

5.9.12 Paraqitja grafike dhe dokumentat plotësues të domosdoshëm për hartimin e projektit Mekanik te Mbrojtjes Kundra Zjarrit ... **Error! Bookmark not defined.**

5.9.13 Roli dhe detyrat e personelit në njohjen, mirëmbajtjen, përdorimin e mjeteve të shuarjes së zjarrit dhe veprimit në rast zjarri ..... **Error! Bookmark not defined.**

5.9.14 Standartet, normat dhe ligjet normative ndërkombëtare dhe kombëtare**Error! Bookmark not defined.**

5.10 Impjanti i furnizimit me ujë të ftohtë hidro/sanitar (H/S)Error! Bookmark not defined.

5.10.1 Përdorimi i ujit të ftohtë sanitar. ..... **Error! Bookmark not defined.**

5.10.2 Nevojat për ujë të ftohtë hidro/sanitar. ..... **Error! Bookmark not defined.**

5.10.3 Mënyrat e furnizimit me ujë primar dhe sigurimi i rezervës ujore**Error! Bookmark not defined.**

5.10.4 Centrali i pompimit..... **Error! Bookmark not defined.**

5.10.5 Rrjeti i shpërndarjes, komponentët impiantistikë ..... **Error! Bookmark not defined.**

5.10.6 Materialet e tubacioneve dhe komponentë impiantistikë në rrjetet e brendshme..... **Error! Bookmark not defined.**

5.10.7 Filtrimi i ujit sanitar..... **Error! Bookmark not defined.**

5.10.8 Impjanti i ujit të ngrohtë sanitar ..... **Error! Bookmark not defined.**

5.10.9 Parametrat e ujit të ngrohtë sanitar ..... **Error! Bookmark not defined.**

5.10.10 Nevojat e ujit të ngrohtë sanitar të bëhet sipas standarteve**Error! Bookmark not defined.**

5.10.11 Përgatitja e ujit të ngrohtë sanitar ..... **Error! Bookmark not defined.**

5.10.12 Dimensionimi i rrjetit të ujit të ngrohtë sanitar ..... **Error! Bookmark not defined.**

5.10.13 Rrjeti i shpërndarjes, komponentët impiantistikë .... **Error! Bookmark not defined.**

5. 11 Impjanti i shkarkimit të ujrave të zeza dhe të përdoruraError! Bookmark not defined.

5.11.1 Klasifikimi i shkarkimit të ujërave ..... **Error! Bookmark not defined.**

5.11.2 Dimensonimi i rrjeteve të sistemit shkarkimit, vlerat normative të shkarkimit 169

5.11.3 Vlerat e njësi të shkarkimit sipas aparateve..... 169

5.11.4 Dimensionet e kolonave të shkarkimit 170

5.11.5 Ventilimi i rrjeteve të shkarkimit..... 170

5.11.6 Përpunimi i ujrave të shkarkimeve 171

5.11.7 Materialet e tubave dhe komponenteve kryesor të rrjetit të shkarkimit 171

5.12 Impjanti i ngrohjes, ventilimit, kondicionimit (H.V.A.C)Error! Bookmark not defined.

5.12.1 Të dhënat meteorologjike dhe kushtet e jashtme të mjedisit. 156

5.13 Kushtet e projektimit ..... **Error! Bookmark not defined.**

5.13.1 Normat projektuese dhe vlerat e rekomanduara të temperaturave të ambienteve 157

5.14 Impjanti i kondicionimit ..... **Error! Bookmark not defined.**

5.14.1 Ngrohja ..... **Error! Bookmark not defined.**

5.14.2 Tipologjitë e impjanteve të ngrohjes ..... **Error! Bookmark not defined.**

5.14.3 Impjantet e ngrohjes ..... **Error! Bookmark not defined.**

5.14.4 Ftohja ..... **Error! Bookmark not defined.**

5.14.5 Ventilimi - Ajri i freskët ..... **Error! Bookmark not defined.**

5.15 Centralet termike dhe pajisjet mekanike ..... **Error! Bookmark not defined.**

5.15.1 Centralet termike 160

5.15.2 Pajsjet mekanike ..... **Error! Bookmark not defined.**

6. KONSTRUKSIONI 174

6.1 Standartet për projektin konstruktiv 174

7. AKSESIBILITETI NGA PERSONAT ME AFTËSI TË VEÇANTA/ BARRIERAT ARKITEKTONIKE ..... **Error! Bookmark not defined.**

MATERIALET QE DO TË SIGUROHEN NGA ENTI PROKURUES

1. Detyra e projektimit për çdo objekt arsimor
2. Studimi i Fizibilitetit për infrastrukturën arsimore parauniversitare

RRUGA E SIGURIMIT TË PROJEKTIT TË PLOTË

a. Faza e projektimit skematik dhe konceptual e cila do të sigurohet <u>nga firmat konkuruese</u>:

- Koncepti i objektit
- Genplan i pergjitshem i objektit dhe sistemimet e jashtme, shkalle 1-500
- Skeme distributive, organizimi i hapesirave te shkolles
- Planimetri e te gjitha kateve te propozuar e mobiluar, shkalle 1-200
- Te pakten nje prerje A-A shkalle 1-200
- Fasadat e objektit, shkalle 1-200
- Te pakten 4 imazhe render te jashtme, 2 imazhe render te hapesirave te brendshme
- Te pakten 1 aksionometri volumentirke ose render
- Relacion i projektit
- Preventiv i plote i ndertim – montimit dhe mobilimit te objektit
- Metodologjinë e zbatimit të punimeve

b. Faza e projektit të zbatimit e cila do të sigurohet <u>nga firmat fituese</u>:

Projekti i paraqitur për “Ndërtimi i ri i shkollës Tip2 në Njësinë Administrative Nr.6 (Sheshi 6/3) duhet të përmbajë:

- Planin e vendosjes së strukturës, i cili do të hartohet në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit pranë Bashkisë së Tiranës.
- Raportin Teknik arkitektonik dhe konstruktiv.
- Projektin arkitektonik: Fasadat, Planimetritë e objektit, Prerjet e godinës, Plan mobilimin e ambienteve, Plani i tarracës, etj.
- Projektin e konstruksionin të objektit: Plani i strukturave dhe detajet, Plani i themeleve, etj.
- Plan qarkullimi i personave me aftesi te kufizuar
- Projekt Zbatimin e instalimeve hidrosanitare, të kanalizimeve.
- Projektin e zbatimit të instalimeve elektrike, të rrjetit telefonik, internetit të shoqëruara me licencën e noteruar të projektuesit.
- Projekt Zbatimin e instalimit te sistemit të ngrohjes, të mbrojtjes kundër zjarrit të miratuar nga Drejtoria e Zjarrit dhe Shpëtimit, pranë Prefekturës së Qarkut Tiranë.
- Projektin e sistemimit dhe të gjelbërimit të oborrit, projektin e ambienteve të lodrave;
- Specifikimet Teknike për zërat e punimeve, pajisjet dhe mobilimi që permban projekti
- Grafikun e punimeve te detajuar sipas zërave të punës.
- Detaje arkitektonike, shtresash, dyer/dritare, mobilje etj
- Materialet e ndërtimit që do të përdoren
- Raport gjeologjik
- Raport Sizmik
- Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM)

I gjithë materiali i përgatitur në fazën e projekt zbatimit do të dorëzohet në gjashtë kopje të printuara dhe në mënyrë elektronike me CD.

Gjithashtu projektuesi duhet të paraqesë

- Licencë të shoqërisë projektuese + ekstrakt të Regjistrit Tregtar
- Licenca të inxhinierëve projektues, licenca të ekspertit mjedisor + deklarata noteriale të inxhinierëve projektues.
- Planvendosja e objektit në shkallën 1 : 1000 format A3 (kopje origjinale);

VARIANTI 1

Hartimi i Preventivit

Kosto totale e ndërhyrjes do të përcaktohet nga preventivi përfundimtarë i objektit, që do të përgatitet bazuar në projektin e zbatimit, specifikimeve teknike duke marrë parasysh edhe kërkesat e veçanta të Bashkisë në lidhje me standardet e

pranuara dhe me çmimet për njësi sipas **Manualit Teknik të Çmimeve në fuqi ose analizat teknike te çmimeve per zërat jashtë manualit.**
1.1

VARIANTI 2

Hartimi i Preventivit
Preventivi i dale nga projekti
Preventivi përfundimtarë i objektit, që do të përgatitet bazuar në projektin e zbatimit, specifikimeve teknike duke marrë parasysh edhe kërkesat e veçanta të Bashkisë në lidhje me standardet e pranuara dhe me çmimet për njësi sipas Manualit Teknik të Çmimeve në fuqi ose analizat teknike te çmimeve per zërat jashtë manualit.

Kosto e ndërtim montimit
Kostoja totale e ndërtim-montim dhe mobilim do te bazohet tek preventivi përfundimtar i objektit duke dhene çmimet e firmës zbatuese per cdo ze te parashikuar ne kete preventiv. Ky preventiv duhet te jete brenda fondit limit te parashikuar nga autoriteti kontraktor. Pikerisht kjo kosto do te jete pjese e ofertës se përgjithshme, ne kete menyre mund te krahasohet cilësia e projektit me cilësinë e zbatimit brenda te njëjtit fond limit.
1.2
Standardet
1.3
Standarde në Projektim
Projekti do të hartohet në përputhje me të gjitha normat dhe standardet për projektim që parashikon legjislacioni në fuqi. Projektimi duhet të sigurojë respektimin e standardeve, madje edhe atyre gjatë zbatimit. Është përgjegjësi e Projektuesit saktësia dhe respektimi i të gjitha standardeve dhe normave përkatëse. Projektuesi mund të rekomandojë edhe prezantimin e standardeve të reja, për përafrimin me normat e BE-se, si dhe të praktikave më të mira ndërkombëtare në projektim dhe zbatim. Rekomandimet duhet të përmbajnë elemente të fizibilitetit dhe realizueshmërisë me praktikën shqiptare dhe limitimet për financimin e veprës. Në hartimin e projektit të mbahen parasysh të gjitha normat e miratuar për personat me aftësi të kufizuar, të verbrit, etj. Në projekt të parashikohet infrastruktura e nevojshme për këtë kategori.
Detajet teknike të infrastrukturës për ketë kategori, të jepen nga Projektuesi në Fletë të veçanta të Projektit.
Rekomandime për projektuesin

- Projekti do të hartohet në bashkëpunim të ngushtë me grupin e ngritur brenda Bashkisë Tiranë për konsultimin dhe mbikëqyrjen e procesit të projektimit.
- Projektuesi duhet të përdorë dhe të rishikojë të gjithë informacionin ekzistues lidhur me zonën ku do te ndërtohet shkolla. Të dhënat e nevojshme për projektim, siç janë: gjendja e rrjetit ekzistues të ujësjellësit, të kanalizimeve, ndriçimit, kabinat e tensionit të lartë, planin rregullues të

zonës, etj, duhet të sigurohen nga projektuesi përmes aplikimeve për informacion në institucionet përkatëse.

- Projektuesi duhet të përdorë studimet dhe të dhënat paraprake që disponohen nga Bashkia e Tiranës.
- Cilësia e studimit duhet të jetë e tillë që të arrihet në standardin e kërkuar.

Llogaritjet, specifikimet teknike dhe preventivi

Relacioni teknik që shoqëron projektin duhet të përmbajë:

- Raportin teknik të projektimit arkitektonik
- Raportin teknik të projektimit konstruktiv ku duhet të përfshihet edhe raporti mbi llogaritjet për gjithë strukturat (themelet, shkallëve, soletave, arkitrarëve, trarëve, etj.) si dhe masat inxhinierike që janë parashikuar të merren, siguria e kalimit në objekt gjatë kryerjes së punimeve të ndërtimit. Në këtë raport do të bashkëngjiten dhe anekset përkatëse ku janë të gjitha llogaritjet përfshirë modelin kompjuterik të llogaritjeve për kontrollet eventuale nga ana e investitorit.
- Relacionin sizmologjik të truallit (kur nuk ka studim, një përshkrim i përgjithshëm)
- Specifikimet Teknike të cilat duhet të jepen për çdo zë pune.
- Preventivi i plotë i punimeve të zbatimit
- Relacioni gjeologjik dhe vetitë fiziko-mekanike të dherave ku duhet të paraqiten cilësitë fiziko-mekanike të dherave dhe të shtresave në themelet e objektit të ri dhe atij ekzistues.
- Rekomandime dhe propozime për raste të veçanta.

Paraqitja e vizatimeve

Vizatimet në fazë projekt zbatimi duhet të paraqiten në format A3, të jenë të lexueshme dhe të përmbajnë si minimum fletët si më poshtë:

1. Topografinë e gjendjes ekzistuese në të cilën të jenë të azhornuara të gjitha ndërtimet në gjendjen e sotme (me leje dhe pa leje) dhe relacioni përkatës
2. Planimetria e përgjithshme e objektit në Shk. 1:200; 1:500
3. Planimetritë e kateve të objektit, Shk. 1:100, 1:50
4. Fasadat e reja në 2 D dhe në 3D Shk.1:100
5. Prerjet e godinës (në të dy drejtimet) Shk.1:100
6. Planimetria e themeleve Shk.1:100
7. Prerje të themeleve dhe detajet Shk.1:20; 1:10
8. Plani i strukturave detaje Shk.1:100; Shk.1:50
9. Planimetritë e mobilimit të shkollës Shk.1:100
10. Planimetria e rrjetit të kanalizimeve në shkallën Shk. 1: 100
11. Puseta dhe detaje të tjera të rrjetit të kanalizimeve Shk.1:10, 1:20
12. Planimetria e furnizimit me ujë në Shk. 1: 200, 1:100
13. Skemat aksonometrike e furnizimit me ujë, detaje të paisjeve hidrosanitare Shk.1:100
14. Puseta dhe detaje të tjera të rrjetit të ujësjellësit Shk.1:20, 1:10

15. Planimetria, aksonometria dhe detaje të sistemit të ngrohjes Shk.1:100
16. Planimetria dhe detaje të sistemit të mbrojtjes kundër zjarrit Shk.1:100
17. Planimetria e dhomës së kaldajës, konstruksioni, detaje Shk.1:100;1:50
18. Planimetri dhe detaje për ndriçimin, fiksimin e ndriçuesve në tavan, instalimin e kuadrit kryesor etj. Shk.1:100;1:50
19. Planimetria e skemës së shpërndarjes së fuqisë në të gjithë objekti, Shk. 1:100
20. Planimetritë për telefoninë, rrjetin e internetit Shk.1:100; 1:50
21. Planimetria e ndriçimit të jashtëm dhe detaje të tij Shk.1:100; 1:50
22. Planimetria e ambienteve sportive dhe ambienteve të gjelbëruara dhe detaje Shk.1:100; 1:50.
23. Planimetria e murit rrethues, tipin dhe detajin e fiksimit të stolave, Shk.1:100; 1:50.
24. Planimetria disiplinimit dhe shkarkimit të ujërave sipërfaqësore dhe detajet përkatëse shk. 1:100; 1:50.

Në fletët e vizatimit të konstruksionit të objektit duhet të jepen dhe tabelat e specifikimit për çdo material, hekur, beton, tulla etj.

REFERENCAT

Referenca te pergjithshme

- Udhëzimet ekzistuese për shkollat P të Shqipërisë, të cilët tashmë përdoren si dokumente referuese nga planifikuesit, projektuesit dhe mbikëqyrësit e zonave të punës;
- Ligji për arsimin i MAS-it;
- Normat ISO për ndërtimtari;
- Ligjet e tjera të Shqipërisë, duke përfshirë Ligjin për mbrojtjen e mjedisit, Ligjin për planifikimin e territorit, rregulloret për mbrojtje nga zjarri; Ligjin e ndërtimit; Udhëzimi për Kushtet teknike të objekteve ndërtimore për qasjen e personave me aftësi të kufizuar; Rregullore teknike për kursimin e energjisë termike dhe mbrojtjen termike në ndërtesa;
- Kurrikulumi i ri për arsimin e përgjithshëm;
- Projekte të ndryshme standarde për ndërtimin e shkollave në Shqipëri dhe
- Udhëzime të tjera të përgatitura paraprakisht nga konsulenti.

Referenca speficike

- VKM nr.319, dt 12.04.2017, "Pwr miratimin e standardeve tw projektimit tw shkollave"

- VKM nr.98, Dt. 06.02.2013, "Për miratimin e listës së Standardeve të Harmonizuara Shqiptare, që kanë karakter referues për prezumimin e konformitetit për produktet e ndërtimit

- Normat ISO për ndërtimet.

- VKM, Nr. 68, datë 15.2.2001, Për "Miratimin e Standardeve dhe të kushteve teknike të projektimit dhe të zbatimit të punimeve të ndërtimit".

- VKM, Nr. 1503, Dt. 19.11.2008, Për miratimin e rregullores “ Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuar”.

	Pajisje për demostrimin e forcave paralele (Leva)	1 copë	Përbëhet nga një vizore metalike (40-50)cm e gjatë, me vrimë dhe diametër (3,5-4,5)mm, e shkallëzuar Përdoret për të studiuar marrëdhëniet ndërmjet forcës, krahut të saj dhe momentit të forces dhe shërben për të varur gurë peshash me çengela
	Pajisje për demostrimin e forcës së Arkimedit (Cilindri i dyfishtë i Arkimedit)	1 copë	Diametri ø 28mm, lartësia 55mm, masa e cilindrit 35 g, materiali plastik
	Pajisje për demostrimin e parimit të ruajtjes së energjisë mekanike	1 copë	Lartësia ~ 250 mm, përmasat e kompletit ~380x130x150mm, rrotulla ø 110mm.
	Pajisje për demostrimin e përhapjes së shtypjes në lëngje (Ligji i Paskalit)	1 copë	Sfera material çeliku, madhësia ~350 mm, pesha ~300 gram
	Pompë vakumi dore	1 copë	Trysnia e vakumit duhet të jetë më e vogël se 6700 Pa
	Pajisje për matjen e shtypjes në lëngje	1 copë	Shkallëzimi i përgjithshëm jo më pak se 24 cm, me qendër të shkallëzimit 0
	Pe-Plumbçe	1 copë	Spango e fiksuar në një sferë të vogël
	Peshore fizike-teknike me gurë peshimi	1 copë	Kapaciteti maksimal (200 – 300)g, ndjeshmëria 0.1g, toleranca e gabimit jo më shumë se 1.5, diametri i tavës ø(90-110) mm
	Sfera të madhësive të ndryshme	1 komplet	Diametër (10-20)mm, metal çeliku
	Sensor i shtypjes së gazit	1 copë	Kërkon sinjal proporcional me trysninë e gazit
	Sensor i lëvizjes	1 copë	Shërben për të llogaritur distancat, që përshkon trupi,duke njohur kohën nga dalja e sinjalit deri në marrjen e tij. Shpeshtësia është 50 matje

			në sekondë dhe shkalla e matjes nga (0.15 -6) m. Lidhet me smartboard E46. Komandohet me touchscreen
	Sensor i forcës	1 copë	Sensori i forcës mat forca tërheqëse dhe shtytëse prej -50N +50N. Lidhet me smartboard. Komandat i merr me touchscreen
	Rrafsh i pjerrët (tribometër)	1 copë	Prej druri
	Shtypësi hidraulik		
	Shiritmetër	1 copë	Plastik, metalik, 1,5m, 2m,
	Stativë metalike me aksesorë	1 copë	Diametri i shufrës ø 10-13 mm, bazamenti hekur trekëndësh, lartësia 700-900mm, 1 shufër me kokë izoluese, 1 shufër me çengela, 2 morseta
	Susta të pa shkallëzuara	10 copë	Pesha maksmiale e lejuar deri në 500gram
	Trupa me dëndësi të ndryshme dhe me vëllime të njëjta	6 copë	Trupa me forma dhe përmasa të njëjta prej materialesh të ndryshme si: dru, plastmas, bronz, alumin, hekur, plumb etj.
	TERMODINAMIKA		
	Aparat për ndryshimin e përcjellshërisë termike	1 copë	Përbëhet nga tre shufra metalike prej metalesh të ndryshme,të pajisura me unazë metalike të lëvizshme , me përmasa (300 x 150) mm
	Aparat për ndryshimin e bymimit të trupit të ngurtë (Pirometër)		
	Aparat për demostrimin e bymimit të lëngjeve dhe të gazeve		Ilustron ndryshimet gjatë bymimit të lëngjeve. Përbëhet nga 5 tuba qelqi me fund sferik, lartësi 400 mm, montuar në bazament plastik dhe shkallëzuar në mm.
	Aparat për demostrimin e bymimit të trupave të ngurtë	1 copë	Diametri i sferë s ø20 mm, pesha 0.2kg, gjatësia 300 mm
	Aparat për shndërrimin e energjisë termike B29	1 copë	Përbëhet nga : gypi prej bakri, kapëse të gropëzuar, tapa plastike dhe spango fërkimi. Lartësia rreth 470 mm, pesha rreth 600 gram,
	Aparat për demostrimin e Ligjit e Boil-Mariotit	1 copë	Përmasa 300 x 200 mm, kapaku prej gome , Gypi cilindrik prej qelqi, Vëllimatësi, Matësi i shtypjes, shkalla e matjes 0.5,1,1.5,2.
	Barometër mësimor	1 copë	Trup metalik analog diameter 10cm
	Barometër aneroid	1 copë	Mat trysninë e ajrit, në vlerat (690-790) mm Hg, dhe me shkallëzim 1mm Hg
	Enët komunikuese	1 komplet	4 gypa qelqi me support plastik
	Pajisje për demostrimin e konveksionit B51		Diametri i gypit ø12mm,

			përmasat: 300mm x 200 mm. Vlerat numerike të specifikimeve teknike janë fleksibël deri në 15%.
	Kalorimetër	1 copë	Prej bakri, i veshur me nikel me përmasa 54x34 m Për përxcaktimin e nxehtësisë specifike të lëngut me metodë elektrike. Përbëhet nga një kalorimetër bakri i veshur me nikel, me përmasa (54 x 34)mm, që futet brenda një ene të jashtme me përmasa 70x45 mm.Tensioni i ushqimit elektrik U = 6V, Rezistenca e ngrohesit R=2-6 Om, Rryma : I=0.5--2 A.
	Lama dy-metalike	1 copë	Materiali: bakër, hekur, gjatësia afërsisht 200 mm.
	Sensor temperature	1 copë	Shkalla: -30/+1350C Rezolucioni: 0.10C Shpeshtësia: mbi 10 matje/s Lidhet me smartboard. Komandohet me touchscreen. E109 .
	Sensor i trysnise së gazit		Kërkon sinjal proporcional me trysninë e gazit. Vlera e kërkuar është 156.050 kPa. Njësia matëse e trysnisë mund të jetë Bar, kPa, atm. Shpeshtësia është 100 matje në sekondë dhe shkalla 0-200 kPa. Lidhet me smartboard. Komandohet me touchscreen. Grumbullimi dhe hedhja e të dhënave me USB. Lidhje permanente me kordë.
	Motor me djegie të brendshme	1 copë	
	Termometër (0-50) gradë Celsius	10 copë	Shkallëzimi (0-50) gradë me zhivë
	Termometra (0-200) gradë Celsius	10 copë	Shkallëzimi (0-200) gradë me zhivë
	Termometra (-10-110) gradë Celsius	10 copë	Shkallëzimi (-10-110) gradë me zhivë
	ELEKTRICITETI DHE MAGNETIZMI		
	Ampermetër laboratorik	4 copë	Shkalla e matjes -0,2~0~0,6A / -1~0~3A, ndjeshmëria 75 mV, Përmasa afërsisht (133 x 97 x 100)mm
	Ampermetër-voltmetër për demostrime	1 komplet	DC rryma evazhduar,1mA,100mA,1A,10A, DC tensioni (0-10)V,(0-30)V AC/alternative 10mmA,100ma,1A,5A AC tensioni 10V,30V,250V
	Aparat për shpërndarjen e ngarkesës elektrike	1 copë	Sferë metalike e montuar mbi një dorezë izoluese
	Aparat për veprimin e forcës magnetike mbi	1 copë	Përmasat: afërsisht

	përcjellësin me rrymë		(500x250x270) mm I=2A
	Aparat për demostrimin e Ligjit të Kulonit	1 copë	Bazamenti metalik, fija me palcë shtogu
	Aparat për demostrimin e vijave të fushës magnetike		Kuti me përmasa (98x55x55)mm, me tunel, diametër i brendshëm 10mm dhe gjatësi 70mm dhe shufër magnetike me përmasa(50x7)mm gjateëi.
	Burim drite (bateri)	5 copë	3 V, 4,5V
	Busullë mësimore shkollore	1 copë	Diametër jo më pak se (50) mm
	Bobina Rumkorf	1 copë	220V/50Hz,dalja (20-100)Kv,distance 100mm
	Çift bobinash induksioni	3 komplete	Bobina primare ø35mm, gjatësia 120mm dhe 380 spira dhe bobina sekondare ø65mm,481 spira , si dhe me bërthamë hekuri
	Çelës thike me kasetë	1 copë	Tension 36V dhe rrymë të vazhdueshme 6A
	Çelës për qarkun elektrik	5 copë	U= 36V me rrymë të vazhdueshme 0-3A
	Fije percjellese	10 copë	50cm gjatësi me spina fundore dyanëshe
	Elektroskop me fletë	1 copë	Diametër jo me i vogël se200mm, me mbështetës me material plastik ose prej qelqi
	Elektromagnet në formë patkoi	1 copë	Përbëhet nga dy bobina, njera me bërthamë prej shufre celiku ne forme U, me nje armature metalike mbyllëse me çengel dhe tension 6V dhe rrymë 1A.
	Gjilpërë magnetike me suport	3 copë	Gjatësia e gjilpërës jo më pak se 40mm
	Gjilpëra magnetike të vogla	3 copë	gjatësia jo më e vogël se 30 mm
	Gypa plastikë	6 copë	Prej materiali plastik
	Kafazi i Faradeit	1 copë	Përmasat (600x300x150)mm
	Kabllo përcjellëse me spina fundore	10 copë	Me gjatësi 50cm dhe spina fundore dyanëshe
	Kondensator me disqe	10 copë	Disqe pecigllas me diameter (200-300)mm
	Kuti rezistencash montuar në kasetë	1 komplet	10x0,1Ω; 10 x 1 Ω; 10x10 Ω; 10x100 Ω; 10x1000 Ω
	Llambushka	25 copë	Tip standard, 6V
	Mbajtëse llambushkash	1 komplet	Bazament plastik , me portollambë U= (0-30)V, I=(0-3) A
	Modeli i gjeneratorit trefazor	1 copë	Dalja > ose = 8V kur shpejtësia rrotulluese afërsisht 1600 rrot/minutë
	Maketi i një elektromotori	1 copë	Përmasat 50cmx50cm
	Magnet në formë patkoi	2 copë	80mmx200mm, 0,05T80mm x 200mm2, 0,05T.

	Magnet i thjeshtë	4 copë	5x25cm
	Pajisje për dëndësine e ngarkesave	1 copë	Përmasat (600x300x150)mm
	Pila e Voltës	3 copë	Me shufër karboni, pllakë bakri, pllakë plumbi, pllake zinku
	Pendolini elektrizues	1 copë	Suport plastik me fije mëndafshi
	Përcjellës drejtvizor me pllakë plastike	1 copë	Përbëhet nga tre përcjellësa të ndryshëm, bazamentet plastikë
	Rekord për urën Ëinston	1 copë	(1000x100x50)mm, tel Ni-Cr
	Reostat 50U me kursor (me rrëshqitje)	1 copë	Rezistenca (0-50) om, rryma1.5A
	Rrjeta elektrostatike	1 copë	
	Rrezet katodike	1 copë	(640x440x590)mmm me support plastik
	Sistem burimesh alternative B46		Përdoret për eksperimente të ndryshme për studimin e energjive të ripërtërishme, si diellore, hidrike dhe të erës. Përbëhet nga panel diellor, turbinë me erë, turbinë hidraulike, qelizë me hidrogjen, ventilator, elikë. Përmasat 50x45x15 cm. Pesha 5.5 kg
	Seri fijesh metalike, montuar mbi pllakë	1 komplet	Materiali i fijeve: hekur, bakër, nikel-krom
	Sferë me dorezë izoluese	1 copë	Doreza plastike ose sfera metalike me diameter jo mëtë vogël se ø50mm
	Shufër qelqi	2 copë	Gjatësia jo më e vogël se 300 mm
	Shufër ebaniti	1 copë	Gjatësia jo më e vogël se 300 mm
	Shufër shkarkuese	10 copë	Bishti plastmase - shufra metalike (500-700)mm
	Shufër magnetike	2 copë	Me pole të ngjyrosur 160mm, 0,06 T (160 x 200) mm, 0.06T.
	Spektrat magnetikë	1 copë	(500x330x250)mm
	Stimulues i sigurisë elektrike		Simulon problemet teknike të sistemit elektrik: qarkun e shkurtër, rrjedhjen e rrymës, mbingarkesën dhe siguresën. Vendoset në një kasë alumini e mbushur me foam. Dimensionet afërsisht: 30x35x10 cm.
	Sensor i tensionit dhe rrymës	1 copë	Sensor I kombinuar.Shpeshtësia e matjeve 50000matje/s.lidhet me smartboard.Komandohet me touchscreen.
	Transfomator	1 copë	
	Tuba geisler (burim drite me gaze të ndryshme)	1 komplet	Tubat me hidrogjen, oksigjen, helium,dyoksid karboni, neon, argon.
	Ushqyes universal (0-24)V, 6A	1 copë	Daljet e rrymës alternative dhe tëvazhduar (2-24)V me 12 shkalle. Rryma maksimale e punës deri në 6A.

			Përmasat afërsisht (270 x 120 x 210) mm, 6,5 kg
	Volmetër laboratorik	3 copë	Shkalla e matjes -5~15V, ndjeshmëria 1mA. Përmasat afërsisht (133 x 97 x 100)mm
	AKUSTIKA, LËKUNDJET, VALËT		
	Aparat për demostrimin e dukurisë së përhapjes së valëve	1 copë	Tensioni (0-6)V; numri i vibrimeve 13; ø i vibratorit 15,6mm, përrmasat (450mmx200mmx300mm)
	Diapazon 440Hz	1 copë	Përbëhet nga : dy pirunj me të njëjtën frekuencë 440 Hz, me seksion tërthor (6,5 x 16)mm, gjatësia e krahëve 109 mm, distanca midis 17mm,
	Lavjerrës matematik	1 copë	
	Lavjerrës për rezonancë	5 copë	5 lavjerresa me gjatësi të ndryshme, korniza metalike (400 x 300) mm.
	Kuti rezonance	1 kuti	e përshtatshme për diapazon 440 Hz; afërsisht 145x88x53 mm
	Komplet sustash	1 komplet	Përdoren për demonstrimin e valëve gjatësore dhe tërthore. Susta 1 me diametër 8 cm, gjatësia e pazgjatur 13 cm, mund të zgjatet deri afërsisht 5 m, pesha 0.6 kg. Susta 2 me diametër 2 cm, e pazgjatur me gjatësi 1 m, pesha 0.5 kg.
	Sonometër me tri korda	1 komplet	Përdoret për hulumtimin e varësisë së tingullit nga gjatësia, tensioni dhe trashësia e kordës vibruese. Përbëhet nga një kuti rezonance prej druri me gjatësi 60 cm, me shkallëzime. Kompletohet me dinamometër, dy korda çeliku me diameter, Φ0,4 mm, një kordë çeliku me diameter,Φ0,8 mm dhe tri urëza të lëvizshme për përshtatjen e gjatësisë së kordave.
	OPTIKA		
	Aparat fotografik	1 copë	Digital, cyber shot, mbi 10 Mega pixel.
	Disku optik	1 copë	Burimi i dritës 6V/ diametri i ekranit 130mm/diametri i pasqyrës 35mm
	Disk me ngjyra i Njutonit	1 copë	Disku me ngjyra me litar rrotullues Përdoret për zbërthimin e dritës së bardhë.perbëhet nga disku me diametër 200 mm, me dy sete spektresh me ngjyra, një rotor me dorezë që e rrotullon. Boshti i dorezës përputhet me boshtin e

			diskut. Vendoset mbi një bazë plastike me përmasa afërsisht (120x120) mm, me këmbëza gome, lartësia e përgjithshme afërsisht 32 cm.
	Pasqyrë e lugët	2 copë	Prej qelqi F' = 65mm, ø=100mm
	Pasqyrë e mysët	2 copë	Prej qelqi F' = 65mm, ø=100mm
	Pasqyrë e rrafshët	1 copë	Largësi vatrore f=65mm, ø = 100 mm
	Filtra me ngjyra të ndryshme	1 komplet	Plastike, 40x20 mm7 ngjyrat baze te spektrit, me dimensione afërsisht 535x310 mm secili filter
	Modeli i syrit	1 copë	Pamja fizike e funksionimit të syrit, përfshirë defektet e të parit dhe korrigjimin e tyre. I montuar në bazament druri ose plastik dhe ka përmasa jo më të vogla se (320 x 180)mm
	Kaleidoskop	1 copë	Diametër (180 x 35)mm
	Thjerrë përmbledhëse	2 copë	Prej qelqi
	Thjerrë shpërndarëse	2 copë	Prej qelqi
	Thjerrë plan-mysët	2 copë	Prej qelqi
	Prizëm prej qelqi	1 copë	Pika e pamjes 85^0, 25mm-75mm / 50mm-15mm
	Pllakë qelqi me faqe paralele	1 copë	
	Rrjetë qeramike	1 copë	1235x125 mm dhe 150x150mm
	Qelq zmadhues	2 copë	Me zmadhim jo më të vogël se 4 herë
	Sensor i dritës		Shkalla: (0 -2 000)lux / (0 -30 000) lux Rezolucioni: 0.5 lux/10 lux Shpeshtësia: mbi 1000 matje/s Lidhet me smartboard. Komandohet me touchscreen.
	Spektroskop i vogël	1 copë	
	Spektroskop për demostrime	1 copë	
	TË PËRGJITHSHME		
	Aparat fotografik	**1 copë**	Digital, cyber shot, mbi 10 Megapixel
	Alkool	1 shishe	1kg alkool në shishe qelqi
	Acid sulfurik	1 shishe	250 gram në shishe qelqi
	Bekera qelqi	10 copë	100ml, 250ml,500ml, prej qelqi
	Cilindra të shkallëzuar	10 copë	25ml, 100ml,500ml, prej qelqi
	Disku me ngjyra	1 copë	Disk me ngjyra me litar rrotullues, diametër 200mm
	Erëmatës	1 copë	Plastik ose inoks
	Ene qelqi me forma të ndryshme, por me vëllim të njëjtë	5 copë	100ml, 250ml,500ml, prej qelqi
	Enë qelqi me forma dhe vëllime të ndryshme	5 copë	100ml, 250ml,500ml, prej qelqi
	Gurë peshimi me çengela	1 komplet	Kuti me 10gurë metalik, 50gr.secili
	Gota kimike	5 copë	Gotë kimike 50 ml 100 ml 250 ml
	Gyp plastik me diametër të ndryshëm	5 copë	Transparentë, ø = 6-8 mm
	Gyp qelqi i vogël në formë U-je	5 copë	ø = 16mm, h= 150mm

	Gërshërë punëdore	1 copë	Prej hekuri me dorezë plastike, gjatësi 10cm
	Hinka qelqi	3 copë	Prej qelqi
	Kapëse provëzash	1 copë	Prej druri
	Llamba me alkool	4 copë	Prej qelqi me alkool, me kapak dhe fitil
	Lapsa me ngjyra	2 paketa	Kuti me lapsa me ngjyra druri dhe uji
	Lapustila me ngjyra	5 copë	Lapustila me ngjyra
	Llastik	10 m	Llastik i hollë
	Lugë për substanca	2 copë	Prej qelqi, inoks, plastike
	Mbajtëse provëzash	2 komplete	Prej druri
	Mikroskop	1 copë	Mikroskop i thjeshtë
	Naftalinë	200 gr.	Reagent kimik i pastër
	Nivel tregues	1 copë	Dru pse material plastik, me flluskë ajri
	Ngjitëse	2 copë	Ngjitëse të vogla dhe të mëdha
	Parafinë	250 gr.	Reagent kimik i pastër
	Pikatore	3 copë	Qelqi me kapese gome, rreth 10cm
	Plastelinë	1 pako	Me ngjyra 70x150mm
	Pluhur hekuri	200 gr.	Reagent kimik i pastër
	Peshore teknike me gurë peshimi	1 copë	Peshore e thjeshtë me pjata
	Provëza	6 copë	Prej qelqi, 12x100mm
	Poça koneke me vëllime të ndryshme	3 copë	Vëllimi100 ml 250 ml 500ml
	Pe-plumbi	1 copë	Plumb i varur në fije
	Pjata petri	4 copë	Me material prej petri
	Poça sferikë me vëllime të ndryshme	4 copë	Vëllimi100 ml 250 ml 500ml
	Raportor plastik	1 copë	Tip standard, bazamenti 50cm
	Spango	10 m	Fije e pazgjatshme
	Sfera të madhësive të ndryshme	10 copë	Përmasat me diameter (50-100) mm
	Suport plastik me fije mëndafshi	1 copë	Përmasat (500x300x250)mm
	Susta	1 komplet	Diametër 8 cm, gjatësia 13 cm,pesha 0,6 kg
	Trazues qelqi	2 copë	Prej qelqi, 30-50 cm
	Tullumbace	10 copë	Me ngjyra të ndryshme
	Topa pingpongu,tenisi, futbolli	3 copë	Topa pingpongu,tenisi, futbolli
	Rrjeta qeramike	1 copë	125x125mm ose 150x150mm
	Sulfat bakri	1 shishe	250gram
	Shishe qelqi për lëngje	5 copë	Vëllimi 60ml, 100ml
	Shiringa plastikë	3 copë	Të mëdha, plastike
	Shi-matës	1 copë	Plastik ose inoks , klasik PVC
	Acid sulfurik	1 shishe	250gram
	Vizore e gjatë plastike	1 copë	Përmasat 100 cm
	Vizore trekëndore	1 copë	Përmasat (30x40x50) cm
	Xhama sahati	2 copë	Prej qelqi
	TABELA MËSIMORE		
	Sistemi ndërkombëtar i injësive SI	1 copë	Përmasat (70x100)cm
	Ligjet e gazeve	1 copë	Përmasat (70x100)cm
	Makinat e thjeshta	1 copë	Përmasat (70x100)cm
	Shndërrimet e gjendjeve të lëndës	1 copë	Përmasat (70x100)cm
	Parimi i punës së motorrit me avull dhe i turbinës	1 copë	Përmasat (70x100)cm

	Fusha magnetike	1 copë	Përmasat (70x100)cm
	Toka si magnet	1 copë	Përmasat (70x100)cm
	Shndërrimet fazore të lëngjeve	1 copë	Përmasat (70x100)cm
	Bymimi i trupave të ngurtë	1 copë	Përmasat (70x100)cm
	Modeli i elektromotorit	1 copë	Përmasat (70x100)cm
	Transformatori	1 copë	Përmasat (70x100)cm
	Modeli i gjeneratorit trefazor	1 copë	Përmasat (70x100)cm
	Modeli i ziles elektrike	1 copë	permasat (70x1000cm
	Parimi i gjeneratorit	1 copë	Përmasat (70x100)cm
	Induksioni elektromagnetik	1 copë	Përmasat (70x100)cm
	Tensioni elektrik	1 copë	Përmasat (70x100)cm
	Ligji i Ohmit	1 copë	Përmasat (70x100)cm
	Elektromagneti	1 copë	Përmasat (70x100)cm
	Fusha magnetike e solenoidit me rrymë	1 copë	Përmasat (70x100)cm
	Lidhja e përcjellësve në paralel	1 copë	Përmasat (70x100)cm
	Rregulla e dorës së majtë	1 copë	Përmasat (70x100)cm
	Eklispi i Hënës	1 copë	Përmasat (70x100)cm
	Glob (paraqitja fizike dhe politike)	1 copë	Me bazament në tavolinë ose në tokë
	Dhoma e errët	1 copë	Përmasat (70x100)cm
	Elekstroskopi	1 copë	Përmasat (70x100)cm
	Qark i lidhjes në seri	1 copë	Përmasat (70x100)cm
	Qark i lidhjes në paralel	1 copë	Përmasat (70x100)cm
	Qark me lidhje të shkurtër	1 copë	Përmasat (70x100)cm
	Qarku hidraulik dhe elektrik	1 copë	Përmasat (70x100)cm
	Parimi i punës i motorrit me avull	1 copë	Përmasat (70x100)cm
	Skema e prodhimit të energjisë nga hidrocentrali te shtëpitë	1 copë	Përmasat (70x100)cm
	Sistemi hidraulik i frenave	1 copë	Përmasat (70x100)cm
	Sistemi diellor dhe planetët	1 copë	Përmasat (70x100)cm
	Pasqyrimi dhe përthyerja e dritës	1 copë	Përmasat (70x100)cm
	Pasqyrimi i plotë i brendshëm	1 copë	Përmasat (70x100)cm
	Përthyerja e rrezeve të dritës nga prizmi prej qelqi	1 copë	Përmasat (70x100)cm
	Zbërthimi i dritës së bardhë dhe bashkimi i ngjyrave	1 copë	Përmasat (70x100)cm
	Syri dhe defektet e tij	1 copë	Përmasat (70x100)cm
	Instrumentet optikë (aparati fotografik,teleskopi,mikroskopi)	1 copë	Përmasat (70x100)cm
	MJETE TË SIGURISË		
	Syze mbrojtëse plastike	1 copë	Masa per fëmijë (12- 15) vjeç
	Kutia e ndihmës së shpejtë (mjete të sigurisë gjatë punës në laborator)	1 komplet	Kuti e tipit klasik e ndihmës së shpejtë

3.2 4.1 Projektimi për personat me nevoja të veçanta

Projektimi/dizajnimi i ndërtesave shkollore duhet të siguroj qasjen e papenguar, lëvizjes, qëndrimit dhe mësimnxënies të nxënësve me nevoja të veçanta, referuar legjislacionit perkates, per kete kategori. prandaj, projektuesit duhen të bazohen në këtë legjislacion por edhe në këtë udhëzues ku jane paraqitur kushtet teknike

më specifike për ndërtesat shkollore. Llojet e nevoja të veçanta për të cilat mund të përkujdesemi në një shkollë standarde do të kufizohen, për arsye praktike, në ato me nevoja të veçanta në lëvizje, humbje të dëgjimit që korrigjohet me pajimet për dëgjim, dhe humbja e pjesërishme ose e tërësishme e të parit, pas trajnimit adekuat. Mirëpo, kategoria e fundit nuk do të jetë në gjendje të marrë pjesë në të gjitha aktivitetet shkollore të mësimdhënies ose të mësimnxënies.
Personat me nevoja të veçanta mund të jenë nxënës, arsimtarë, mysafirë ose personel. Problemi i tyre kryesore është reduktuara në lëvizshmërinë e tyre për arsye se ata shfrytëzojnë karrocat e invalidëve, patericat ose bastunët. Ky problem kërkon dimensionim të veçantë të zonave të qarkullimit, hapësirave të dyerve, pajisjeve sanitare, shtigjeve të evakuimit dhe hapësirave të klasave për tu akomoduar personat me nevoja të veçanta.
Dimensionet e personave me nevoja të veçantë nëpër karrocat e invalidëve duhet të kihen parasysh nga projektuesit gjatë caktimit të madhësisë së hapësirave të shkollës dhe qarkullimit. Karrocat e invalidëve kanë dimensione të ndryshme, sipas moshës së nxënësve dhe llojit të artikullit. Megjithatë, dimensionet e mëposhtme, përkojnë me dimensionet mesatare të personave të rritur, e që duhet të merren parasysh (shih fig. 1.3.13 dhe 3.14) :

- Gjerësia e karriges përgjithësisht është mes 600 dhe 700 mm
- Gjatësia është mes 1000 dhe 1250 mm
- Rrezja e jashtme është mes 1300 dhe 1500 mm



Fig. 1.3.13

Hapësira deri ku mbërrijnë personat me nevoja të veçanta në karrocat e invalidëve definohet:

- Mes 230 dhe 300 mm mbi nivelin e dyshemesë;
- Mes 1100 dhe 1300 në lartësi;
- Mes 300 dhe 400 mm nga pjesët anësore të karriges;



Fig. 3.14

Qasja në hapësirat dhe ndërtesat e jashtme

(c) Qarkullimi i jashtëm

- Parkim i posaçëm për automjete duhet të parashihet me një hapësirë më të madhë në njërën anë (3.80 m në vend se të jetë 2.5 m gjerësi);
- Kufijtë e shtigjeve të këmbësorëve duhet gjithmonë të kenë skaje të ndërprera dhe hapësirat për këmbësorë gjithmonë duhet të jenë të ndara nga trafiku i automjeteve me gurë (blloqe) trotuaresh;
- Shtigjet duhet të respektojnë minimumin e kërkuar me gjerësi prej 1.5 m për një karrocë standarde invalidësh, sipërfaqja për kthim dhe mbulesat e dyshemesë duhet të jenë bërë nga materiale kundër-rrëshqitëse dhe të jenë të lira nga pengesat ndaj lëvizjes së lehtë;
- Lakorja e pjerrtësisë në rruginën ku ecet nuk duhet të jetë më e pjerrët se 1:12 ose 5% dhe pjerrinat e gjata duhet të jenë të ndara në faza;
- Trotuaret duhet të kenë minimum gjerësinë prej 0.90 m nëse janë të projektuara për një kahje dhe 1.80 m për të dyja kahjet;
- Sinjalizimi duhet të jetë i dukshëm dhe racionalisht i vazhdueshëm;
- Qasja në të gjitha ndërtesat duhet të jetë e arritshme nga personat me nevoja të veçanta mundësisht me platforma, pjerrina e të cilave nuk duhet të tejkalojnë 1:12 (5%) me pushimore të rrafshët pas çdo 9 m gjatësi të platformës;

- Të gjitha kalimet nëpër fushat e lojërave dhe fushat sportive duhet të jenë të projektuara me platforma sa herë që një gjë e tillë është e nevojshme. Pjesa përfundimtare e këtyre platformave duhet të jetë e bërë nga materiale kundër-rrëshqitëse siç janë blloqet e betonit, gurët ose asfalti;

- Platformat duhet të jenë të pajisura me nga një parmak anësor dhe/ose bllok trotuari përgjatë gjatësisë së platformës;

(d)Hapësirat e brendshme

- Hyrjet kryesore të ndërtesave duhet të jenë qartazi të dallueshme, të lehta për tu hapur dhe të thjeshta për të kaluar përmes tyre;

- Pragjet e dyerve duhet të evitohen ose të kenë lartësinë maksimale prej 20 mm;

- Në hapësirat e mësimdhënies, hapësira e punës me diametër prej 1.5 m duhet të mbahet e lirë dhe e pangarkuar, ashtu që karroca e invalidëve të mund të kthehet dhe të pozicionohet para tavolinës;

- Dërrasat e shkrimit duhet të jenë të kapshme nga pozita ulur. Dërrasa, lartësia e së cilës mund të rregullohet mund të jetë një opsion;

- Ndërrimet e vogla në nivel duhet të shmangen. Aty ku janë të pashmangshme, platformat e vogla janë më të preferueshme se shkallët;

- Për t’ju vene ne ndihme nxënësve me shikim të dobësuar, dyer tërësisht të glazuara duhet të shmangen, ngjyra të ndryshme duhet të përdoren në shkallët për pushimoret dhe shkallët, dritaret në fund të korridoreve duhet të shmangen (kontrasti I tepruar në ndriçim);

- Ashensori(ët) duhet të vendosen afër hyrjes së ndërtesës, hapësira e ashensorit duhet të jetë mjaft e madhe për karroca të invalidëve, ndërsa shenjat dhe kontrolli duhet të jenë të arritshme nga personat me nevoja të veçanta. Kabina e ashensorit duhet të përmbajë edhe shenjëzimet si: alfabeti i Braille , pranimi akustik dhe vizual i thirrjes dhe lajmërimi me zë në kat.

3.3 4.2 Shkolla si Qendër Komunitare

Nisma “Shkolla si Qendër Komunitare” është shkolla e hapur ndaj komunitetit, shkolla që vihet në shërbim të plotë të komunitetit, pa cenuar procesin e mësimdhënies, duke e plotësuar atë përtej orarit zyrtar.
Per kete eshte e nevojshme qe projektuesi te mendoje per programin e funksioneve te shkolles edhe aksesin nga komuniteti jashte orarit zyrtar te shkolles. Zgjidhjet arkitektonike duhet te jete te tilla qe ofrojne fleksibilitet duke

arritur ne te njejten kohe sigurine ne shkolla, e nga ana tjeter pas mesimit ambjentet e saj te jete lehtesisht te skesueshme.
Shkollat perfshire territorin e tyre duhet te ndahen ne 3 kategori privatesie. A. Funksione teresisht per shkollen, nxenesit dhe stafin e shkolles. B. Hapesira per shkollen por edhe per komunitetin. C. Hapesira terisht per komunitetin.

- A.Funksione teresisht per shkollen jane ato funskione qe do te perdoren vetem nga nxenesit dhe stafi i shkolles, te tilla si klasat, laboratoret, mjediset e stafit etj. Duhet te garantohet hyrja e tille qe te plotesoj sigurine e nevojshme te ketyre ambejnteve, te limitohen hyrjet dhe daljet, te jene lehtesisht te kontrollueshme.

- B. Hapesirat per shkollen dhe per komunitetin jane ato funksione qe do te sherbejne ne orarin mesimore per nxenesit dhe stafin dhe ne oraret pas mesimit zyrtar per komunitetin. Keto funksione jane, palestra, hapesirat per shume qellime (auditori, salla e koncerteve, ekpozita, mbledhje prinderish etj), Bibloteka. Ne keto raste duhet te mendohet menaxhimi i aksesit. Projektuesi duhet ti projektoje keto hapesira duke krijuar kases te lehte per komunitetin, mundesisht te drejtperdrejt nga jashte pa kompromentuar hapesirat si koridore apo klasat. Keto ambjente duhet te kene tualete te perdorshme nga komuniteti. Projektuesi duhet te mendoje per keto hapesira specifike sesi mund te funksionojne edhe te integruara me shkollen, por edhe ne menyre te vecante dhe te pavarur.
  Gjithashtu oborri i shkolles te mendohet fleksibel duke pasur parasysh sigurine e e shkolles por ne te njejten kohe, te jete lehtesisht i transformueshem ne hapesire publike e perdorshme nga i gjithe komuniteti pas orarit te mesimit. Qe do te thote, aksesi te jete i lehjte, rrethimi, te jete trasprent mjaftueshem, si dhe porta hyrese sa me e madhe. Te jete me gjelberim dhe peme per te krijuar hije mjaftueshem, stola per tu ulur si dhe ndricim urban edhe per naten.

- C. Hapesira teresisht per komunitetin, jane ato hapesire qe ne oraret e funksionimit te shkolles ose jo jane gjithmone te aksesueshme per komunitetin. Projektuesi duhet te mendoje qe nje pjese nga oborri i shkolles, qe perkon edhe me hyrjen ne kete oborr te krijoje hapesire publike ku kjo sherben sin je hapesire publike per komunitetin, ku nxenesit e perdorin jashe orarit mesimore, ku prinderit sjellin dhe presin femijet nga shkolla et. Te jete me gjelberim dhe peme per te krijuar hije mjaftueshem, stola per tu ulur si dhe ndricim urban edhe per naten.

3.4
3.5 4.3 Komoditeti Termik (Temperatura)

3.5.1 4.3.1 Përkufizimet dhe terminologjia

Komoditeti termik zakonisht i atribuohet dy parametrave kryesorë: (1) ndjenjës së komoditetit termik si rezultat i bilancit mes kalorive të akumuluara dhe të humbura në trup, dhe (2) kontrollit të kushteve termike, duke përfshirë pozitën e diellit dhe rrezatimit, temperaturën, lagështinë dhe erërat. Projektuesit e ndërtesave të shkollave duhet të marrin parasysh kushtet termike të zonës ku parashihet të bëhet ndërtimi. Në këto udhëzime janë paraqitur të përgjithshme në lidhje me kushtet termike në Shqipëri, por të dhëna shtesë dhe më të detajuara duhet të grumbullohen për kushtet e sakta të zonave përkatëse, siç janë: (1) minimumi dhe maksimumi i temperaturës mesatare mujore, (2) higrometria lokale, dhe (3) erërat mbizotëruese për çdo stinë klimatike dhe shpeshtësia e erërave forta dhe stuhive.

3.5.2

3.5.3 4.3.2 Përmirësimi i komoditetit termik

Për të përmirësuar komoditetin termik të hapësirave të shkollës, masat e mundshme për kontrollin e temperaturës janë klasifikuar në dy kategori:
Masat **natyrore** ose pasive, që përfshijnë orientimin e ndërtesës, pozitën dhe dimensionet e hapjeve, cilësinë e materialeve, izolimin termik, mbjelljen e pemëve në afërsi të ndërtesave etj.
Masat **artificiale** ose aktive, që përfshijnë mjetet mekanike ose ato elektrike, siç është ngrohja, ajrosja.
Persa i perket sistemit te ngrohjes, te perdoren sistemi i kaldajes ku si lende te pare perdoret pelleta.

Persa i perket sistemit te ftohjes, shkolla duhet te projektohet ne menyre te atille qe te garantoje nje temperature te ajrit 26°C qe është kufiri për punë komode në shkolla, ku me lëvizjen e duhur të ajrit nga rrjedha e ajrit natyror, nga dritaret e hapura dhe qarkullueset e ajrit, këto nivele zakonisht mund të arrihen në klasat gjatë vitit.

Ventilimi i objektit te projektohet i tille qe te garantoje cilesine e ajrit permes ventilimit natyror. Ne ambjentet qe ventilimi natyrior nuk eshte i mundur, ateher te mendohet zgjidhja nepermjet sistemeve artificiale te ventilimit.

Për kontrollin e efekteve termike në hapësirat e shkollës, projektuesit duhet të ndërmarrin disa masa të thjeshta në fillim të procesit të projektimit. Këto masa kanë të bëjnë me:

- **Orientimin e ndërtesave**: rekomandohet që orientimi i hapësirave të klasave të jetë drejt lindjes dhe perëndimit meqë ky orientim ofron mbrojtje nga rrezet e drejtpërdrejta të diellit. Ky orientim i preferuar mund të devijojë për rreth minus ose plus 30° (për shkak të kërkesave të lokacionit, ose për shkak të orientimit të erërave mbizotëruese) pa pasur ndonjë ndikim të madh në komoditetin e klasave mësimore (shih figurën më poshtë);
- **Vendosjen e ndërtesave**: largësia mes ndërtesave duhet të jetë në proporcion me lartësinë e ndërtesave për të lejuar qarkullimin e ajrit të

pastër dhe dritën natyrore edhe në nivelet më të ulëta. Për të njëjtat arsye, një largësi minimale prej 4m duhet të mbahet në mes të faqeve kryesore dhe murit rrethues. Gjithashtu fasada jugore e shkollës nuk duhet të jetë më afër se 10m nga ndërtesa më e afërt me të.

- **Formën dhe dizajnin** e ndërtesave, si për shembull, mundësia e qarkullimit të tërthortë të ajrit për ripërtëritjen e ajrit të freskët me ajrosje natyrore gjatë stinës së nxehtë, ose zgjedhja e kulmit me katër nivele të pjerrësisë në zonat me reshje të mëdha të dëborës;
- **Sipërfaqet e mbjella**: mbjellja e bimëve mund të luajë një rol thelbësor në krijimin e mikroklimës, kur është e nevojshme. Mbjellja e bimëve kontribuon në mënyrë efektive në mbrojtjen nga pluhuri, erërat dhe rrezet e diellit. Përveç kësaj, mbjellja e shkurreve dhe kaçubeve bëjnë të mundur mbrojtjen kundër reflektimit të rrezeve të diellit nga toka;
- **Elementet e duhura të ndërtesës**: kjo përfshin kullimin e duhur nga çatia dhe kullimin rreth ndërtesave, krijimin e hijeve me kanate të rregullueshme nëpër dritare, ndalesa të diellit, perde për diell, çadra dhe/apo galeri që mund të sjellin mbrojtje shtesë nga rrezet e diellit, sidomos kur orientimi i ndërtesës nuk është i favorshëm.

Materialet e duhura të ndërtimit, që përfshijnë materialet e fasadave me reflektim të mundshëm të diellit, materialet izoluese për rritjen e veprimit termik të mureve dhe të kulmit, me materiale që duhet të jenë joalergjike apo të dëmshme për shëndetin e nxënësve.

3.5.4 4.3.3 Kontrolli aktiv i temperaturës

- **Temperaturat e ulëta:** niveli komod i temperaturave më të ulëta mund të konsiderohet ai mes 19°C, për vendet ku ushtrohen veprimtari të punës që nuk përfshijnë lëvizje, dhe 15°C, për zonat e qarkullimit. Përpjekjet për të siguruar nxehtësi në mënyrë që të arrihen këto nivele të temperaturave në mjediset e brendshme, zakonisht nuk duhet të jenë shumë të larta. Megjithatë, një minimum shumë më i ulët mund të ndodhë në secilin prej muajve të sezonit të ngrohjes, ku sistemi i ngrohjes duhet të ketë kapacitetet të reagimit ndaj këtyre temperaturave të ulëta.

- **Temperaturat e larta**: Klima e Shqipërisë është kryesisht e thatë dhe e nxehtë nga maji deri në shtator, ku shumica e ditëve gjatë kësaj periudhe janë me diell. Muajt më të nxehtë janë korriku dhe gushti me variacione rajonale për shkak të lartësisë. Megjithatë, temperaturate ajrit 26°C është kufiri për punë komode në shkolla, ku me lëvizjen e duhur të ajrit nga rrjedha e ajrit natyror, nga dritaret e hapura dhe qarkullueset e ajrit, këto nivele zakonisht mund të arrihen në klasat gjatë vitit.

3.5.5 4.3.5 Standardi i izolimit

Sa më i mirë të jetë termoizolimi i një elementi konstruktiv të jashtëm përballë ajrit të jashtëm, aq më e vogël është mundësia e daljes së ajrittë ngrohtë jashtë.

Elementët konstruktive të izoluara keq, kanë temperaturë të ulët të sipërfaqeve të brendshme; sa më i keq të jetë ky izolim aq më i madh është rreziku që në sipërfaqe nën ndikimin e një lagështie të shëndetshme relative të ajrit prej 40-60%, temperature kritike minimale zbret nën 12,6 °C.
Vëmendje të veçantë duhet tu kushtohet zonave të ashtuquajtura ura termike si p.sh. tavanet e mureve të jashtëm, pasi këtu temperatura e sipërfaqes mund të jetë më e ulët se sa ajo e elementeve konstruktive në zonat e rregullta.

3.5.6**4.3.6 Urat termike**

3.5.7

Urat termike janë pika të dobëta termike të lokalizuara në mbulesën transmetuese termike të ndërtesës. Në krahasim me sipërfaqet e pashqetësuara të elementeve konstruktive, në këto pika ndodh një humbje e madhe termike nga brenda jashtë. Sa më i lartë standardi energjitik i një ndërtese, aq me rëndësi është eleminimi i urave termike.

- **Llojet e urave termike**

  - Urat termike gjeometrike të kushtëzuara krijohen, nëse madhësia e sipërfaqeve thithëse dhe çliruese termike ndryshojnë, si p.sh. në këndet e jashtme të ndërtesës, trashësitë e ndryshme të elementit konstruktiv ose kollonave të dala.
  - Urat termike të kushtëzuara nga lloji i materialit krijohen gjatë përdorimit të materialeve me përçueshmëri të ndryshme termike dhe me këto karakteristika të ndryshme izoluese, të cilat mund të janë të vendosura në krah ose mbi njëra-tjetrën. Në këtë mënyrë, në vendin e materialit të ndërtimit me përçueshmëri më të lartë termike krijohet një rrymë termike më e lartë. Një shembull tipik janë elementet konstruktive prej betoni brenda një muri të jashtëm me tullë.
  - Urat termike konvektive krijohen kur energjia termike e një rryme ajri transportohet nëpërmjet mbulesës së ndërtesës përçuese termike. Ato shkaktohen nga mos hermetizimet e sipërfaqes. Bashkimet e hapura të shtresës izoluese në zonën e çatisë apo mosizolimi i fugave të dritareve janë shembuj të krijimit të këtyre urave termike.

Një numër i madh i urave termike mund të mënjanohen nëpërmjet punës së mirë projektuese, supervizimit të kujdesshëm dhe nëpërmjet përzgjedhjes së materialeve të duhura.

- **Këshilla gjatë projektimit**
  - Të mënjanohen strukturat me shumë degëzime;
  - Të vendosen ndarje termike të elementeve konstruktive konsol (pllakat e ballkonit, kollonat, konsolat mbajtëse) me strukturat në kufi;
  - Shtresa të pandërprera të materialit izolues p.sh. sistemet termozioluese të mureve të jashtme dhe kalimet e niveleve të veçanta izoluese pa dobësim të vlerave termoizoluese.

3.5.8 4.3.7 Kërkesa e vlerave të U(Ë/m²K)(koeficientii transmetimit termik)

Sipas legjislacionit ne fuqi (Ligji Nr. 8937 dt. 12.09.2002 „Per ruajtjen e nxehetesise ne ndertesa" dhe akteve nenligjore perkatese VKM Nr. 38 dt. 16.01.2003 „Per miratimin e normave, rregullave dhe kushteve te projektimit dhe te ndertimit, te prodhimit dhe ruajtjes se nxehetesise ne ndertesa") per zonen klimatike A te ciles i perket Tirana (me pak se 1500 Grade Dite Ngrohje ne vit) Koeficienti i humbjeve volumore Gv per ndertesa eshte midis 0.54 – 1.03 Ë/m³°C. Vlera me e vogel eshte per ndertesa me raport S/V (siperfaqe te jashtme/volum i ngrohur) me te vogel se 0.3 dhe vlera me e larte per ndertesa me raport S/V me te madh se 0.9. Per ndertesa me S/V ndermjet ketyre vlerave, koeficienti Gv llogaritet proporcionalisht. Ne menyre qe koeficienti I humbjeve volumore te plotesoje kerkesat e ligjit duke respektuar njekohesisht dhe kriterin ekonomik kosto-perfitim, eshte llogaritur qe ndertesat ne Tirane duhet te kene nje shtrese termoizolimi te jashtem (tip kapote) polisterol EPS me trashesi 5 cm (U = 0.35 Ë/m^0 K) ose me fiber minerale me te njetet parametra te transmetimit te nxehetesise dhe me dritare me dopjo-xham (6 x 12 x 6 mm) me profil plastic ose alumin me termoizolim. **Shtresa termoizoluese duhet te jete e instaluar nga jashte** dhe te respektohen me rigorozitet kerkesat e prodhuesve per menyren e fiksimit (pervec materialit ngjites edhe me sistem montimi me vida-upa plastik) si dhe shtresa e barrieres se avujve te ujit. Cdo menyre tjeter instalimi rrezikon te shkatoje kondensim ne muret e brendshme, krijim myku, dhe demtim te shtreses se termoizolimit.

3.5.9 4.3.8 Dritaret dhe Dyert

Depërtimi i dritës natyrale në mjediset e brendshme, fushëpamja e lirë nga brenda jashtë ndërtesës dhe fushëpamja e lirë brenda të gjithë ndërtesës janë elemente mjaft të rëndësishme në mjediset për nxënësit.
Dritaret duhen vendosur si në muret që ndajnë klasat nga Mjediset e jashtme, klasat nga klasa dhe klasat me korridorete brendshme.
Për të përmbushur këto kërkesa duhet të merren parasysh si nxënësit ashtu edhe mësueset / sit . Duhet tu kushtohet rëndësi elementeve si lartësia dhe kornizat e dritareve, lloji i xhamit, qartësia e pamjes (të mos të bllokohet horizontalisht si nga të rriturit ashtu edhe nga nxënësit), kontrolli i dritës, impakti i vlerësimit të riskut, si dhe faktorët e sigurisë. Vlerësimi i sigurisë mund të rekomandojë që stacioni i rojës të pozicionohet brenda qendrës në mënyrë që hyrjet dhe daljet të mund të monitorohen nga rojet e ndërtesës. Ose mund të rekomandohet ndonjë formë alternative për këtë. Projektuesi duhet të përpiqet që të planifikojë të paktën një dritare të jashtme për klasë. Në rast se kjo nuk mund të bëhet por hapësira e brendshme duhet të zihet nga nxënësit, projektimi duhet të parashikojë depërtimin më të mirë të dritës dhe pamjes nëpërmjet vetratave, dritareve anësore, dritareve dhe dyerve me xham (të sigurta). Hapësirat e nxënësve në ndërtimet e reja duhet të kenë një sipërfaqe totale me dritare prej së paku:

- 8 % të sipërfaqes së dyshemesë nëse dritaret janë nga jugu dhe lidhen drejtpërdrejt me mjediset e jashtme.(Shënim: sipërfaqja e xhamit që sheh nga jugu është më e vogël pasi cilësia e dritës që vjen nga jugu është më e mirë.);

- 10% e sipërfaqes së dhomës nëse dritaret orientohen nga lindja apo perëndimi;
- 15% të sipërfaqes së dyshemesë së dhomës nëse dritaret shohin nga veriu;
- 20% e sipërfaqes së dhomës nëse dritaret nuk janë në një mur të jashtëm.

Sipërfaqet që nuk kanë nevojë për dritare janë tualetet, dhoma e konferencave, holli dhe depot.
Nuk lejohet vendosja e skarave metalike në dritare.
Dritaret e jashtme dhe dyert e jashtme me xham duhet te jene me kase me material PVC me ndarje termike ose kase alumini gjithashtu me ndarje termike.
Specifikimet teknike te dritareve duhet te jene te detajuara dhe te marrin parasysh te pakten pikat me poshte:
Koeficientin U - 1.2 (*Ë/m²K*)
Ndarjen Termike –
Qendrueshmerine ndaj faktoreve atmosferike –
Aftesine ze-izoluese – (klasi 4)
Veshja me xham duhet të provojë nje vlerë të lartë të izolimit ndaj rrezeve të diellit (g). Kjo vlerë specifikon sa i lartë është rrezatimi diellor, i cili depërton nëpërmjet xhamit dhe ndihmon kështu në ngrohjen e ndërtesës.Tek xhamat e sotëm të dritareve të termoziluara kjo vlerë këshillohet rreth g = 60%.
Për të shmangur urat termike, duhet që dritarja të montohet nën nivelin e termoizolimit ose të paktën të montohet në këndin e jashtëm të murit. Izolimi kështu vendoset mbi kornizën e dritares. Duhet të kihet patjetër kujdes që gjatë momentit të montimit të realizohet një bashkim hermetikisht i vazhdueshëm i dritares. Montimi me ndihmën e shkumës nuk është i mjaftueshëm, meqenëse ajo në fazën e tharjes mblidhet dhe kështu nuk garanton më një izolim hermetik.

3.5.10 4.3.9 Kontrolli pasiv i temperaturës

Kontrolli mbi depërtimin dhe krijimin e nxehtësisë mund të minimizohet në mënyrë të natyrshme duke projektuar si duhet muret dhe suvatimine ndërtesës. Burimi i nxehtësisë është dielli, ndaj përjashtimi i dritës së drejtpërdrejtë të diellit nga ana e brendshme e ndërtesës është esenciale. Siç përmendet më lart, muret e jashtme mund të anashkalohen si burim i rëndësishëm i krijimit të nxehtësisë së brendshme gjatë ditës në shkollë. Kjo do të thotë se dritaret janë elemente që kërkojnë vëmendje. Kjo arrihet në dy mënyra:me orientim dhe reflektim të diellit.Duhet të theksohet se mjetet për krijimin e hijeve nga dielli brenda xhamit nuk janë të efektshme meqënëse materiali ngrohet dhe krijohen reflektime në brendësi. Është thelbësore që të ndalohet goditja e diellit në xham, nxehtësia nuk reflektohet jashtë përmes xhamit, meqënëse gjatësia valore ndryshohet dhe ambienti ngrohet. Duhet të theksohet se përdorimi i lustrimit të dyfishtë është i paefektshëm për ndalimin e depërtimit të diellit, kjo është efektive në parandalimin e humbjes së jashtme të nxehtësisë.

Orientimi për diellëzimin: drejtimi, ose orientimi më i mirë për të pasur dritë natyrale gjatë ditës në dritare është veri-jug (shiko figurën më poshtë): Orientimi nga Veriu në Shqipëri nuk reflekton drejtpërdrejt dritë të diellit në krahun e dritares, ndërsa orientimi nga Jugu reflekton rreze minimale, në dritare nën këndin më të vogël dhe të ngushtë gjatë ditës: në pjesën më të nxehtë të ditës, dielli do të jenë në zenit dhe këndi i rrezatimit të dritareve drejt jugut do të jetë më i ngushti.



Orientimi i rekomanduar i shkollës

- **Ajrosja (ventilimi i tërthortë)** do të jetë një faktor natyror i komfortit për pjesën më të nxehtë të vitit (shiko figurën më poshtë) por në pikat më të larta mund të ketë më shumë nevojë për të nxjerrë jashtë ajrin që është ngrohur duke kaluar nëpër tokë të ngrohtë e të thatë. Sidoqoftë, ndërtesat me hapësira me opsion të hapjes në të dy anët, nuk janë ekonomike, ndonëse kjo mënyrë rekomandohet si më optimale. Shkolla, si çdo grup ndërtimi tjetër, do të ketë një pjerrësi të shtypjes në kushte dhe drejtime të ndryshme të erës, në mënyrë që ajri të qarkullojë nëpër ndërtesë nga shtypja pozitive dhe negative, deri në atë masë që mundësohet nga ndarjet dhe hapësirat e brendshme. Në këtë mënyrë bëhet freskimi i mundshëm gjatë natës, e që të ndihmohet nga dritat e jashtme që futen nga dritaret e jashtme të nivelit të sipërm.



Komodoteti Termik / Ventilimi i tërthortë

- **Reflektimi i diellit**: pajisje efektive për reflektimin e diellit mund të projektohen për të funksionuar në çdo orientim, meqënëse këndi i diellit është plotësisht i parashikueshëm. Megjithatë, për shkak të ndryshimit sezonal në lartësi, përjashtimi i rrezeve të diellit gjatë vitit do të kërkojë elemente të lëvizshme. Në praktikë, reflektimi është zakonisht një kompromis, edhe në qoftë se është projektuar orientimi optimal, reflektimi pas realizimit do të jetë efektiv. Duke supozuar orientimin nga jugu, dritarja do të reflektohet nga një raft i jashtëm horizontal në nivel të majës

së dritares, me projektim që varet nga kohëzgjatja e vitit që dëshirohet për tëi parandaluar rrezet e diellit që të hyjnë në sallë apo që të bien në dritare. Gjatë dimrit, do të ketë përfitime nga rënia e diellit, kështu që këndi i rënies së diellit që duhet të përjashtohet është ai prej majit deri në tetor. Ka rëndësi thelbësore evitimi i rënies së rrezeve të diellit në dritare pasi nxehtësia është shumë e efektshme kur mjedisi dhe vetë xhami nxehet, duke e rritur kështu efektin e ngrohjes. Duhet të theksohet se përdorimi i xhamave të dyfishtë është i paefektshëm në ndalimin e diellit, dhe është efektiv vetëm në parandalimin e humbjes së diellit nga jashtë. Ndërtimi i një kulmi të madh të dalë jashtë apo masa e dritareve me grila janë pjesë e zgjidhjeve të zakonshme të mbrojtjes ndaj diellit (shih figurën më poshtë), por ne projekt mund te parashikohen edhe masa te tjera qe bejne te mundur uljen e rrezatimit ne dritare, te tilla si brisolete, tendat e jashtme etj. Zgjidhja e propozuar duhet te jete e tille qe te mos pengoje hyrjen e drites por vetem rrezatimin direkt ne xham (jo grila).



Komoditeti termik / Mbrojtja nga dielli

3.6 **4.4 Komoditeti Vizual**

Përkufizimet dhe terminologjia

Nevoja për standarde të larta dhe një ndriçim i projektuar mirë për ndërtesat e shkollave bazohet në:

- **ndriçimin natyror** që rezulton nga drita e diellit e drejtpërdrejtë apo ajo e reflektuar nga toka dhe sipërfaqet e tjera të jashtme apo ato të brendshme;
- **ndriçimin artificial** nga burimet e rrymës elektrike (llambat, tubat fluoreshentë);
- **shkëlqimin** apo intensitetin e dritës qoftë nga burimi natyror apo ai artificial apo nga ndonjë sipërfaqe ose objekt i padepërtueshëm që nuk është transparent;
- **kontrastin** e shkëlqimit apo ngjyrës.

Faktorët mesatarë për reflektimin e dritës

Materialet	**%**
Allçi	85
Letra e bardhë	84
Lyerja e bardhë	75
Çimentoja	55
Gurë gri	50

Lënda natyrore e drurit (ngjyrë e lehtë)	33
Tullat e kuqe	20

Ndriçimit duhet tui kushtohet shumë rëndësi për çdo zonë veprimtarie pasi është element kyç për të krijuar një ambient sa më të ngrohtë.
Cilësia e dritës duhet tui krijojë ndjesinë pozitive nxënësve.
Ndriçimi i madh është më i përshtatshëm për hapësira ku kryhen veprimtari motorike; ndërsa ndriçimi me fokus mbi një detyrë specifike nevojitet për veprimtari manipulative; ndriçimi më i dobët duhet për zonat e qeta .
Sasia dhe orientimi i dritës natyrale duhet të merret parasysh në projektimin dhe variacionin në nivelin e dritës.
Në dhomat me ndriçim të varfër natyral lejohet një maksimum prej 500 lx.
Dhomat që nuk kanë dritare në tavan apo dritare të jashtme, duhet të pajisen me tuba përcjellës së dritës natyrale.
Hapësira dritash të cilat e tejçojnë më thellë dritën në brendësi mund të përdoren në tërë faqet nga jugu. Projektuesit mund tëi referohen tabelës për vlerat minimale të dritës për funksione të ndryshme.
Për më tepër duhet të mbahet parasysh sa vijon: Me dritën e pasqyruar, fëmijët nuk do të shohin në mënyrë të drejtpërdrejtë burimin e dritës, një kusht ky që shkakton shkëlqim verbues dhe lodhje të syrit. Dritat me fokus si ato të varurat të tipit rezidencial, duhet të përdoren kur lexohet, pikturohet dhe bëhet punë e imët.
Projektimi i shumëllojshmërisë në ndriçim me mjete si kontroll të nivelit të dritës, çelës të veçantë, kabllo me orientim të rregullueshëm dhe kabllo të varur duhet të vendosen në zonën e punës. Mund të provohet të vendoset ndriçim specifik për të paraqitur vepra të ndryshme arti, abazhurë me shumë llamba për të krijuar një atmosferë të gëzueshme dhe nivele të larta dritash për të nxitur veprimtarinë fizike.

Zonat e përgatitjes së ushqimit duhet të kenë llamba fikse apo të pathyeshme.
Drita e jashtme duhet të kontrollohet nëpërmjet kondraperdeve apo llojeve të tjera të mbulimit të dritareve. Këto masa duhet të mundësojnë shikueshmëri të qartë.
Ndriçimi i jashtëm duhet të jetë i mjaftueshëm që të mundësojë qarkullim dhe siguri. Të gjitha llambat duhet të kenë lente apo mbulesa për tui bërë rezistente nga thyerja.

Lux i këshillueshëm nëe hapësirat e shkollës

HAPËSIRA	**NDRIÇIMI**	**NDRIÇIM NË LUX**
Klasat	Ndriçim natyral	300
Klasat (pranë dërrasës se zeze)	Ndriçim natyral	500
Laboratorë	Ndriçim natyral	400 - 500
Punëtori	Ndriçim natyral	400 - 500
Dhoma e muzikës / vizatimit	Ndriçim natyral	400 - 500
Zona e magazinimit		300 - 500
Biblioteka		300 - 500
Hapësira shumëpërdorimshe		300 – 400

Salla e edukimit fizik	Ndriçim natyral	300 – 400
Zyra e drejtuesit/nendrejtorit	Ndriçim natyral	500
Sekretariati	Ndriçim natyral	250 - 350
Salla e mësuesve	Ndriçim natyral	500
Salla e personelit ndihmës	Ndriçim natyral	250 - 350
Tualeti		150 – 250
Kabineti i mjekut	Ndriçim natyral	500
Kabineti i psikologut	Ndriçim natyral	500
Depo		250 – 350
Holli	Ndriçim natyral	300 – 400
Shkallët	Ndriçim natyral	301 – 400

3.7 4.5 Komoditeti Akustik

Në ndërtesat e shkollave një vëmendje të veçantë duhet tui kushtohet izolimit akustik. Në nivel urban pozicionimi i shkollës, siç është trajtuar më lart, duhet të jetë në zona të qeta larg akseve të rëndësishme rrugore. Preferohet që pozicionimi i tyre të bëhet në brendësi të zonës së banimit.
Në raste kur kjo gjë nuk është e mundur atëherë zgjidhjet janë të ndryshme, qoftë me barriera fizike si mure, qoftë me barriera fizike të gjelbërta si bimësi të lartë.
Në brendësi të shkollës strukturat duhet të garantojnë një izolim akustik të specifikuar sipas tabelës së mëposhtme:

Elemente konstruktive	**Kërkesat e Rë në dB**
Mure ndërmjet ambienteve të klasave dhe ambienteve të ngjashme	47
Mure ndërmjet ambienteve të klasave dhe korridoreve	47
Mure ndërmjet ambienteve të klasave ose ambienteve të ngjashme dhe shkallëve të ndërtesës	52
Mure ndërmjet ambienteve të klasave ose ambienteve të ngjashme dhe ambienteve “veçanërisht të zhurmshme” (p.sh. Mjediset e administratës)	55

Është e këshillueshme që gjatë projektimit të impianteve dhe të strukturave të tjera të merren parasysh këto rekomandime:

- Të gjitha tubacionet (ajrit të kondicionuar, furnizimit hidrik) që përshkojnë muret që tejçojnë zhurma duhet të vishen me material për mbrojtje akustike;
- Në mjediset ku mendohet se mund të krijohen nivele akustike të larta të vendosen elemente të mobilimit të tilla që të ndihmojnë në uljen e niveleve akustike si p.sh. në korridorre të vendosen linoleum, tapet etj;

- aty ku mundet suvatimi të jetë me materiale që zbusin nivelin akustik;
- për të ulur nivelet akustike, gjatë projektimit të mendohet të përdoren materiale për të zbutur zhurmat brenda kopshtis;
- xhamat e dyerve dhe dritareve duhet të jenë qelq i laminuar akustikisht me nj aftësi izolimi akustik 35dB, me hapësirë ajri nga 50mm deri në 100 mm;
- dyert që hapen nga zonat e zhurmshme duhet të sigurojnë një izolim të lartë akustik
- këshillohet të përdoren materiale tekstile për të ulur nivelin akustik;
- për të izoluar sa më mirë zonën e dhomave me pjesën e jashtme apo me pjesën e administratës mund të përdoren edhe dopio dyer ose sistemi tambur. E njëjta gjë këshillohet edhe për dritaret në zgjidhjen e dritareve dopio. Kjo zgjidhje ndihmon edhe për të arritur një izolim më të mirë termik duke pasur parasysh që dyert dhe dritaret janë dhe zonat më delikate në kuptimin akustik edhe termik;
- kutitë e prizave elektrike nuk duhet të instalohen me kurriz.

- Lokacioni i ndërtesës shkollore: Sipërfaqja e tokës brenda së cilës janë të vendosura ndërtesat arsimore.

- Hapësirat ndihmëse: Hapësirat fizike në ndërtesë shkollore të dedikuara për mbështetje të aktiviteteve arsimore dhe ato administrative.

5
13. TË DHËNA TË PËRGJITHSHME DHE GJENDJA EKZISTUESE E OBJEKTIT

Vendndodhja: Sheshi i propozuar nr. 7/2 për ndërtimin e shkollës tip 4 ndodhet pranë Lumit Lana. Aksesohet nga rruga “Javer Malo” dhe “Stavri Themeli”. Njësia Administrative nr. 7. (Referuar Studimit të Fizibilitetit "*Përmirësimi i infrastrukturave arsimore në Bashkinë Tiranë*" Nëntor 2016).

Përshkrim i sheshit: Në këtë zonë nuk ka shkolla të mesme, por kemi rritje të insitetit të banimit, problematike mund të paraqitet infrastruktura rrugore. Ka një sipërfaqe 8,482 m^2.

Figura 4 *Vendodhja e sheshit 7/2 sipas studimit të fizibilitetit*



Figura 2 *Foto te sheshit 7/2*

14. KËRKESA PROJEKTIMI TË PËRGJITHSHME PËR NDËRTIMIN E SHKOLLËS

Në këtë territor do të ndërtohen:

A. Shkolla për arsimin e mesëm të lartë urban (**Tipi 4**)

Ndërtimi i këtyre objekteve do të plotësojë mungesat e objekteve arsimore në këtë zonë, si dhe do të ndikojë në uljen e numrit të nxënësve në shkollat ekzistuese të cilat ndodhen në kufijtë e kësaj njësie.

Shkolla për arsimin e mesëm të lartë duhet të ketë të gjitha ambientet e nevojshme akademike (klasat mësimore duke përfshirë laboratorët e fizikës, kimisë, biologjisë, informatikës etj), palestër me ambientet ndihmëse të saj, hapësirat administrative, hapësirat shoqërore, etj. Objekti duhet të ketë të instaluar sistemin e ngrohjes qendrore dhe MKZ. Sistemimit të oborrit të shkollës duhet ti kushtohet një rëndësi e veçantë. Ambienti i jashtëm duhet të jetë i sistemuar, duke përfshire ambjentet funksionale përkatëse, terrenet sportive, me gjelbërim dhe me ndriçim të jashtëm

Funksionaliteti

Gjatë projektimit të ndërtesës shkollore, duhet të krijohet një bilanc mes cilësisë së funksionimit dhe efikasitetit të kostos. Ky bilanc mund të arrihet me mjete të ndryshme, siç janë:
Dimensionet racionale të hapësirave:

(xvi) Zonat e përshtatura të qarkullimit: hapësirat e qarkullimit nuk duhet të kalojnë 25% të sipërfaqes së dobishme të ndërtuar. Ato duhet të kenë dimensione dhe të përshtaten sipas shfrytëzuesve të shkollës, ato duhet të jenë funksionale dhe të respektojnë kërkesat për siguri;

(xvii) Numri optimal i hapësirave: numri i hapësirave fillimisht përcaktohet sipas shfrytëzimit.Në shkollat e vogla ku norma e pranueshme nuk mund të arrihet, në veçanti për hapësirat për mësimdhënie të specializuar, hapësirat për qëllime të shumëfishta duhet të merren parasysh;

(xviii) Përshtatshmëri maksimale: hapësirat duhet të projektohen me një përshtatshmëri maksimale, që i mundëson ato të përshtaten për lëndë dhe ndryshime të ndryshme, në ato raste kur kjo përshtatet me kërkesat e tyre funksionale;

(xix) Grupimi i hapësirave: hapësirat duhet të grupohen në blloqe sipas funksionit dhe ndërlidhjes. Kjo do të siguronte një identifikim të lehtë të veprimtarive dhe hapësirave të tyre korresponduese, një komunikim të lehtë mes hapësirave të ndryshme, pa pengesa nëpër zonat e qarkullimit dhe ato të pritjes, një vëzhgim të lehtë të hapësirave dhe një shfrytëzim optimal të tokës në dispozicion;

(xx) Integrimi i nevojave: lokacioni i hapësirave brenda shkollës duhet të ndjekë domosdoshmëritë themelore siç janë rregullat e sanitarisë dhe

higjienës, rregulloret e komoditetit funksional dhe të sigurisë, si dhe komoditetin akustik, vizual e atë klimatik.

Fleksibiliteti

Dizajneri/projektuesi do të duhet të projektojë hapësira të mjaftueshme për fleksibilitet për t'i mundësuar

(vii) personelit të shkollës që të përshtatet me ambientin e shkollës dhe me metodat e ndryshme të mësimdhënies; dhe

(viii) për t'i mundësuar planifikuesve që të adaptohen me ndërtesat për nevojat e ardhshme të shkollës që korrespondojnë me kurrikulumin e mundshëm dhe programet me ardhshme. a) Fleksibiliteti i kërkuar për ndërtesa (dhe orenditë) që mundëson metoda të shumta të mësimdhënies për klasat e zakonshme (mësimi frontal, puna në grupe të vogla, mësimi në formë të seminareve etj.) laboratorë dhe salla të specializuara (puna praktike në gjysmë grupe, kurse demonstrimi në grupe të plota) si dhe hapësirat për qëllime të shumëfishta dhe hallat e sporteve (mundësia e rigrupimit të disa klasave).

2.1 Hapësirat kryesore

Referuar Studimit të Fizibilitetit "*Përmirësimi i infrastrukturave arsimore në Bashkinë Tiranë*" (Nëntor 2016), **Tipi 4** i shkollave, është i mesëm i lartë, për zonat urbane me 21 klasa.

Për realizimin e projektit sipas tipologjisë së shkollës dhe vendit ku do të ndërtohet, referuar “*Udhëzues për projektimin e ndërtesave shkollore normat dhe standardet*”. të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, duhet të merren parasysh këto parametra kryesore:
Arsimi i Mesëm i Lartë, klasa 10 – 12, mosha 17- 19 vjeç;

Numri i cikleve (paraleleve): 7

Numri i Klasave: 21

Numri i nxënësve/klasë 30

Numri total i nxënësve 630

Të dhënat e mësipërme në mënyrë të përmbledhur janë në Tabelën 4.

Tabela 4[4]

[4] *Referuar Tabelës nr 2, Faqe 44_ Studimi i Fizibilitetit "Përmirësimi i infrastrukturave arsimore në Bashkinë Tiranë" Nëntor 2016 dhe Shtojcës V1II5 për shkolla standarde për arsimin e mesme të lartë- viset urbane. Udhëzueis për projektimin e ndërtesave shkollore normat dhe standardet” të hartuara nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës*

Tipi	Vendndodhja	Cikli	Nr. klasash	Nx/Klasë	Nr. nx. total
Tipi 4	Urban	Arsimi i mesëm i lartë	21	30	630

5.1
5.2

5.2.1 2.1.1 Klasat e mësimit

Në projektimin e klasave të mësimit duhet të llogaritet një sipërfaqe 1.94 m^2 / nxënës - 2.18 m^2 / nxënës (optimale) për dhomat e zakonshme të mësimit dhe 1.8 m^2 / nxënës për dhoma të specializuar te mësimit. Lartësia minimale e klasave (dysheme-tavan e përfunduar) duhet të jetë 2.8 m.

Klasat e mësimit janë mjediset kryesore në gjithë organizimin e shkollës. Ato duhet të jenë sa më të përshtatshme për zhvillimlin e mësimit. Kujdes të vecantë tregohet në përcaktimin e formës, përmasave, ndricimit dhe ajrimit natyror, si dhe të mënyrës së mobilimit. Sipërfaqja e klasës varet nga numri i nxënësve të klasës dhe eshte prej 58 deri 65 m2 në zonat me popullsi të dendësisë së lartë (klasë me 30-36 nxënës). Numrit dhe përmasave të bankave në rreshtat ballorë (3 banka të dyfishta) si dhe në rreshtat gjatësorë.
Sipërfaqja e dritareve: sipërfaqja e dritareve këshillohet të jetë sa 1/5 deri në 1/6 e sipërfaqes së dyshemesë, sipas zonave ku ndërtohet shkolla. Për klasat me gjerësi të madhe, në mënyrë që ndricimi të jetë sa më i njëtrajtshëm, lartësia e dritareve mund te shkoje deri në tavan.Materialet e perdorura duhet te sigurojne mbrojtje kundra zjarrit. Nga dyshemeja deri ne 90 cm duhet te jene te pahapshme, dhe mbi 90 cm dritaret duhet te hapen vetem ne menyre vertikale nga lart, ne kete menyre mund te ventilohet objekti por siguron jo kapercyeshmerine e dritares duke rritur sigurine.



DHOMË MËSIMI STANDARDE
30 dhe 36 nxënës
Niveli i Mesëm i Ulët dhe i Lartë

Format planimetrike të klasave, që kështillohen të përdoren, janë drejtkëndore (me raport brinjësh rreth 2:3) dhe afërsisht katrore 6.8 x8.6 m.
Thellësia e klasave kështillohet të mos kalojë 9m, gjithsesi është e detyrueshme që nxënësi të mos jetë më shumë se 6 metra larg dritares nga ku merret dritë.. Klasat duhet që minimalisht të marrin 2 orë dritë direkte.

Fleksibiliteti: Projektuesi do të duhet të parashohë hapësirë të mjaftueshme për fleksibilitet për ti mundësuar personelit të shkollës që të përshtatet me ambientin e shkollës dhe me metodat e ndryshme të mësimdhënies; dhe për ti mundësuar planifikuesve që të adaptohen me ndërtesat për nevojat e ardhshme të shkollës që korrespondojnë me kurrikulumin e mundshëm dhe programet me ardhshme. Fleksibiliteti i kërkuar për ndërtesa (dhe orenditë) që mundëson metoda të shumta të mësimdhënies (shih fig. më poshtë) për klasat e zakonshme (mësimi frontal, puna në grupe të vogla, mësimi në formë të seminareve etj.) laboratorë dhe salla të specializuara (puna praktike në gjysmë grupe, kurse demonstrimi në grupe të plota) si dhe hapësirat për qëllime të shumëfishta dhe sallat e sporteve (mundësia e rigrupimit të disa klasave).



Mësimi frontal, 30 -36 nxënës
Një tavolinë për një nxënës



Mësimi punëtori, 30 -36 nxënës
Një tavolinë për një nxënës

Mësimi frontal, 30 -36 nxënës
Një tavolinë për dy nxënës

Mësimi në grupe



Mësimi punëtori



Mësimi në grupe 30- 36 nxënës



Mësimi në grupe

Llojet e ndarjeve të hapësirës që janë dhënë në programin e projektit duhet të zhvillohen në struktura të cilat mund të modifikohen lehtë për tëu përshtatur kërkesave në të ardhmen. Planifikimi me fleksibilitet është një konsiderim esencial në projektin e shkollave që të akomodojë evoluimin e vazhdueshëm në mendimin arsimor si dhe teknikat e teknologjitë e ndërtimit. I njëjti do të ndihmojë adaptimit të shkollës me shfrytëzimet e reja përmes ndryshimeve në planifikim dhe lejon këto ndryshime pa ndonjë kosto të madhe. Për këtë arsye, një plan fleksibil duhet gjithashtu të mundësojë adaptimet e lehta për zhvillimet në të ardhmen në planifikimin e hapësirës, ndërtimin e ndërtesave, ndriçimin artificial, teknikat e ventilimit dhe të akustikës. Bërja e një ndërtese shumë fleksibile (për shembull me numër të madh të mureve lëvizëse përgjithësisht është shumë e shtrenjtë dhe mund të justifikohet vetëm në rast se ndryshimet janë të nevojshme dhe esenciale. Nuk ka shumë arsye që të vendosim për ndarje të shumta nëse ndryshimet bëhen vetëm një herë në vit.

Këndet vizuale dhe largësitë: Shpesh nxënësit ankohen se nuk janë në gjendje të shohin qartë mjetet vizuale të konkretizimit siç janë dërrasat e bardha dhe video-ekranet. Shpesh shkëlqimi është shkaktar i pamundësisë së nxënësit për të parë qartë. Një faktor tjetër i rëndësishëm është këndi i vijës së shikimit përgjatë të cilës ata shikojnë. Pamundësia për të parë qartë mund ta shtyjë nxënësin që të marrë një pozitë të parehatshme dhe kjo mungesë komoditeti mund të ketë për pasojë humbjen e përqendrimit. Kjo është posaçërisht e vërtetë për nxënësit e moshave më të reja, këndi i shikimit i të cilëve e shtrembëron imazhin madje edhe nëse nuk ka shkëlqim të fortë.

Ekzistojnë disa dëshmi se nxënësit të cilët janë të vendosur aty ku këndi i shikimit është ekstrem, ose largësia nga mjeti i konkretizimit është tepër e madhe, ata kanë të ngjarë të kenë rezultate të dobëta në mësim. Nëse thuhet se të gjithë nxënësit duhet të kenë mundësi të barabarta arsimimi, pavarësisht se ku ulen, atëherë projektuesi duhet ti kushtojë rëndësi më të madhe aranzhimit të ulëseve, në mënyrë që :

• Largësia maksimale ndërmjet rreshtit të fundit të nxënësve dhe dërrasës së shkrimit të jetë rreth 9.0 m. Përtej kësaj largësie është e vështirë të lexohen ato që janë shkruar dhe nxënësit sforcohen shumë për tu perqendruar, për të qenë në gjendje ta kuptojnë tekstin e shkruar;

• Largësia minimale ndërmjet rreshtit të parë dhe dërrasës së shkrimit të jetë rreth 2.0 m. Nën këtë largësi, nxënësit e rreshtit të parë nuk do të jenë në gjendje ta shohin tërë dërrasën e shkrimit nga një kënd i pranueshëm vizual (shih fig. më poshtë);

• Këndi vizual minimal deri te dërrasa e shkrimit duhet të jetë 30° (shih fig. 1.3.6 më poshtë) ashtu që këndi në të cilin shikohet mjeti mësimor i konkretizimit nuk e shtrembëron të kuptuarit nga nxënësit të asaj që ata shohin Nën 30°, leximi i atyre që janë shkruar vështirësohet;

• Drita kryesore natyrale duhet të jetë, sa më shumë që është e mundur, e vendosur në anën e majtë të nxënësve, ashtu që hija e dorës së tyre të mos bartet në tekstin ose vizatimin që janë duke e bërë.



KOMODITETI PËR DHOMË MËSIMI
ME 3 RENDE BANKASH
(30-36 dhe 42 nxënës në raste të jashtëzakonshme)



KOMODITETI PËR DHOMË MËSIMI
ME 3 RENDE BANKASH
(32 dhe 40 nxënës në raste të jashtëzakonshme)

5.2.2 2.1.3 Mobilimi

Hapësira e tavolinës për çdo nxënës

Gjerësia e tavolinës për 1 nxënës

6	deri 10 vjeç	60 cm
10	deri 18 vjeç	65 cm

Thellësia e tavolinës për 1 nxënës

6	deri 10 vjeç	50 cm
10	deri 18 vjeç	60 cm

Lartësia e tavolinës për 1 nxënës

6	deri 10 vjeç	65 cm
10	deri 18 vjeç	74 cm

Distanca ndërmjet dy tavolinave

Distanca e tavolinës në anë:

Deri tek tavolina ose paisje me lartësi maksimale	55 cm
Deri tek muret, radiatorët ose të ngjashme	20 cm
Nga faqja e murit ku është vendosur garderoba	70 cm

Distanca e tavolinave njëra pas tjetrës

Për tavolina me maksimumin 2 vende pranë njëra tjetrës
10- deri 18 vjeç 60 cm

Për më shumë se 2 vende pranë njëra tjetrës
10- deri 18 vjeç 65 cm
Pas rradhës së fundit duhen parashikuar edhe 5 cm shtesë.



Mësimi në grupe

- ***Mobiliet e klasave dhe karakteristikat e tyre***

<u>Klasë mësimi e përgjithshme</u>

13. ***Tavolinë për nxënës, 2 nxënës, përmasa: 1200 / 1300***

Për tavolinat për 2 nxënës sipas grupmoshave i kemi me përmasa:

Grupi i parë: 1200 mm x 500 mm
Grupi i dytë: 1300 mm x 600 mm

Materiali i sipërfaqes së punës:
Pllakë MDF (Medium Density Fiber board, pllakë fibre me densitet mesatar).

Konstruksioni mbajtes:
Skelet tubi në formë ovale ose paralelopipedi. Në të dyja anët, nga jashtë tavolinës, gremç për varjen e çantave.
Materiali prej çeliku të plastifikuar ose të kromuar me spesor 1,5 mm.

14. ***Karrige që mund të stivohen***

Skeleti
Realizuar me alumin, i derdhur, i kromuar, kombinuar me një tub çeliku, me shtresë të sipërme plastike, rezistuese ndaj gërvishtjeve dhe goditjeve, vertikalisht model me

katër këmbë që vihet stiv, me bazament rrëshqitës që lëviz duke bërë të mundur stivimin në rradhë.

Ndenjësja dhe mbështetësja
Punuar me kompesatë me trashësi 8 – 10 mm në formë anatomike, sipërfaqja lyer me llak
Ngjyra sipas dëshirës së porositësit.

15. ***Tabelë e zezë universale dopio***

Tabelë me dy faqe që mund të palosen ku shkruhet me shkumës.

Komunikacion klasik mbi 5 faqe (pasi mund të shkruhet mbi 5 faqe)
Të dhënat teknike të saj janë:

Mënyra tradicionale e paraqitjes
Shkruhet me shkumës
Sipërfaqe e lyer me ngjyrë jeshile, magnetike
E lehtë për tu fshirë, falë strukturës ekstra të imët të sipërfaqes
Kornizë alumini me kënde prej PVC në ngjyrë të lehtë gri.
Sipërfaqe jo gërvishëse dhe rezistente ndaj acideve
Ngjyrë jeshile mat, me sipërfaqe jo reflektuese
2 fletë tabele që mund të palosen, nga të dyja anët e emaluar
Dorëzimi të bëhet duke përfshirë mbajtësen e shkumësave dhe kompletin e montimit.
Përmasat: 90 x (2 x 60) x 120 cm
100 x (2 x 75) x 150 cm
100 x (2 x 100) x 200 cm



16. ***Dollap për në klasë***

Përmasat: afërsisht 950 x 500 x 2030 mm
Pjesa e sipërme dollapit (ndarje për vendosjen e pajisjeve):
Një dysheme dopio e ngjitur fikse (me anë të sistemit me shlice njëlloj si te



dyshemetë me parket) që të shërbejë si ndarje ndërmjet pjesës së sipërme dhe të poshtme të dollapit.
2 rafte me lartësi të rregullueshme me dysheme të vidhosur në të që shërben si sipërfaqe mbajtëse të projektorëve ose të pajisjeve të tjera të klasës (Pesha që duhet
të mbajë rafte është afërsisht 20-25 kg)
Përbëhet nga dy pjesë dollapi.
Për të dy pjesët e dollapit dy kanatë dyersh rrotulluese 270 º, me ristelë mbrojtëse në mbyllje.
Xokolaturë e heqshme – lartësi 150 mm
Materiali melaminë ose MDF.
Trupi, ndarëset e rafteve dhe dyert janë të ngjitura mirë me plastikën nga të dyja anët me 1,0 mm– xokolatura me të paktën 1,5 mm.
Të gjitha bordurat e dyerve, të trupit dhe ndarëset e rafteve janë të veshura nga të gjitha anët me shirit veshës plastik 3 mm.
Skeleti:
2 copë rafte dollapi me lartësi të rregullueshme që lëvizin në dy tuba.
8 copë mentesha të palosshme të tëra prej metali – këndi i hapjes 270 grad,
5.3 2 copë mbështetëse të rrotullueshme prej cilindri në masë të madhe.

2.1.2 Laboratorët

Projektuesi duhet të parashikojë në shkollën e re te mesme te larte:

- 2 (dy) laboratorw informatike
- 3 (tre) laboratorë fizike
- 2 (dy) laboratorë kimie
- 2 (dy) laboratorë biologjie

Në llogaritjen e hapësirës të këtyre klasave laboratorike duhet të merret si bazë hapësira për çdo nxënës si dhe të llogariten ambientet ndihmëse për pajisjet dhe parapërgatitjet.

- ***Mobiliet e laboratorëve dhe karakteristikat e tyre***

10. Laboratori i kimisë

- ***Tavolinë për nxënës dy vendësh me prizë dhe me rubinet***

Përmasat: gjithsej: rreth 1200 x 700 x 700 mm, nga të cilat
Suprina: rreth 1200 x 700 x 40 mm
Skeleti: rreth 1200 x 700 x 700 mm
Dy varëse për çantat

Suprina:

Material qeramike i smaltuar (pa fuga, si një pllakë e vetme) në tre anët e ngritura.
Lidhja me shtyllën e energjisë është rezistuese ndaj acidit dhe nga ana mekanike.

Mbërthimi i suprinës me skeletin metalik bëhet nëpërmjet vidave jo të ndryshkshme.
Dhe rezistente ndaj acideve.
Nën suprinë për çdo nxënës është një vend për vendojen e librave e realizuar me rrjetë metalike prej alumini të kromuar me përmasa: 350 x 350 x 120 mm.
Skeleti:

Në formë tubi çeliku të plastifikuar ose të kromuar, katërkëndor (30 x 30 mm), me spesor 1,5 – 1,8 mm, i realizuar për t’u montuar në dysheme, i përbërë nga një konstrukt kornize të derdhur (jo me copa por si një e tërë) me dy palë këmbë
metalikë; këmbët metalike janë të pajisura me gomina me lartësi të rregullueshme,
për të krijuar një rrafsh horizontal, të pavarur nga disniveli i dyshemesë.

- ***Tavolinë laboratori për mësues me prizë dhe rezistent ndaj acideve***

Përmasat: rreth 1800 x 750 x 900 mm
Suprina:
Përmasat rreth 1800 x 750 x 40 mm, prej materiali qeramiko e smaltuar, sipërfaqe e
madhe me cepa të ngritur në të gjitha anët me lavamanin e instaluar të futur në suprinë (në anën të kundërt të derës që të çon në laborator) me hapësirë të brendshme të paktën 510 x 360 x 300 mm, rezistente ndaj acideve dhe me fuga rezistente ndaj acideve.

- ***Dollap për ruajtjen e pajisjeve laboratorike të kimisë***



Përmasat: rreth 1260 x 550 x 2080 mm Materiali prej melamine të veshur me plastikë dhe me bordurë përreth me shirit plastik të ngjitur në mënyrë fikse ose MDF. 1 fletë melamine ose MDF (trashësi min. 20 mm), ndarëse e rafteve të dollapit me lartësi të rregullueshme 8 fletë melamine ose MDF (trashësi min. 20 mm), ndarëse të rafteve të dollapit që mund të hapen komplet me mbështjellëse mbrojtëse prej material plastik nga të gjitha anët me gjërësi 15 mm. 2 dyer rrotulluese me ristelë mbrojtëse ndaj përplasjes. Bravë me lloz cilindrik dhe shul rrotullues me dorezë të madhe ku kapet.

- ***Tavolinë laboratori rezistente ndaj acideve***

Përmasat rreth 2300 x 1500 x 900 mm

- *Suprina:*

Përmasat rreth 2300 x 1500 x 40 mm
Me material qeramike e smaltuar në sipërfaqe të madhe izoluar dhe rezistente ndaj
acideve. Në pjesën ballore një lavaman (me hapësirë të brendshme minimumi 600 x400 x 300 mm), majtas dhe djathtas lavamanit pajisur me sipërfaqe të pjerrët për rrëshqitjen e pikave të ujit. Në boshtin (aksin) gjatësor dy lavamane në formë hinke (me hapësirë të brendshme të paktën 210 x 210 x 280 mm)
Skeleti i pjesës së sipërme ku vendosen kimikatet.
Përmasat rreth 1800 x 350 x 700 mm.
Skelet me gjashte këmbë në formë tubi me dy rafte; mbërthyer te suprina e tavolinës;
bordura e sipërme e raftit të parë rreth 550 mm mbi suprinë; në pjesën e poshtme në
të gjithë gjatësinë dhe gjërësinë mes skeletit metalik përgatitur bordurë installimi
gati 150 mm e lartë. Bordura e sipërme e raftit të dytë rreth 700 mm mbi suprinë; në anën e lavamanit rikthyer në pozicionin e saj gati 300 mm. Të dyja raftet të mberthyera në mënyrë të palëvizshme me skeletin metalik.

- *Komodinat e poshtme*

Përmasat e përgjithshme (përfshirë dhe xokolaturën) rreth 2180 x 1380 x 860 mm
Lartësia e xokolaturës 150 mm. Izoluar me tokën.
4 komodina secila me 4 sirtarë dhe 3 mbajtëse për çdo sirtar
4 komodina secila me nga një ndarëse sirtari dhe një derë rrotulluese.
1 hapësirë e lirë poshtë suprinës për të vendosur larësin e mjeteve laboratorike.
Poshtë pjesës ballore të lavamanit derdhës një strehë me derë rrotulluese. Të gjitha

menteshat metalike janë rezistente ndaj gërryerjeve dhe veshur me lëndë plastike.

- *Furnizimi me ujë*

Në pjesën ballore të lavamanit një dalje vertikale rreth 300 mm e lartë, në një pozicion të mirë të jashtëm, me shkarkimin për ujin e ftohtë e të ngrohtë në distancë
rreth 200 mm nga aksi i tubit vertikal, me 3 valvula shkarkuese; nga te cilat një valvul është për ujin e ngrohtë me bateri të përzierjes (grup lavamani), e lidhur me
furnizimin me ujë të ngrohtë (rrjet qëndror i ujit të ngrohtë ose me nje boiler të vogel
10 litra të tipit nën tavolinë).
Lavaman në formë hinke: me një valvul e thjeshtë në një dalje vertikale rreth 300 mm të lartë, shkarkimi rreth 150 mm nga aksi vertikal; një valvule dopjo në një shtylle vertikale rreth 300 mm të lartë, shkarkimi rreth 150 mm nga aksi vertikal, distanca rreth 120 mm.

11. Laboratori i fizikës / biologjisë

- ***Tavolina për nxënës 3 vendëshe me prizë***

Përmasat: gjithsej – rreth 1800 x 600 x 760 mm; nga të cilat
Suprina : rreth 1800 x 600 x 25 mm
Skeleti: rreth 1800 x 450 x 730 mm
Të dhënat mbi lartësinë pa përfshirë vidhat që shërbejnë për ta rregulluar atë
Hapësira e lirë: minimumi i lartësisë 650 mm
Këmbët metalike janë të rradhitura majtas (Vështruar nga vendi i nxënësit)
Sipas planskicës shoqëruese
Hapësira e lirë: Lartësia minimumi 650 mm
Suprina:
Është një pllakë melamine ose MDF; që del mbi skelet nga anë e gjatë e tij 75 mm
Skeleti: me profil në formë tubi ose katërkëndor, përshtatur për tu montuar në dysheme, dhe i përbërë nga një konstrukt kornize i derdhur (kompakt), pa
ndërprerje, me katër palë këmbë metalike. Këmbët metalike janë të pajisura në fund
me vidha rregullatore për të krijuar një rrafsh horizontal të pavarur nga nivelimi i dyshemesë; këmbët metalike në sektorin e kutisë së instalimit, me një distancë prej
75 mm, mbuluar nga të gjitha anët me pllaka melamine ose MDF. Kapaku i kutisë është i çmontueshëm nga njëra anë e brendshme në mënyrë që të bëhet instalimi.
Gjashtë gremça (kapëse) për të varur çantat e shkollës.
Instalimet elektrike në kutinë instaluese:
Nga ana e mësuesit: dopjo prizë 220 V, buton emergjence stakues për furnizimin me
energji në të gjitha tavolinat e nxënësve, 4 copë priza me kapacitet të lirë, një prizë
me tokëzim. Të gjitha prizat të futura 4 mm.
Nga ana e nxënësit: dopjo prizë 220 V
Tavolina e nxënësit vendoset sipas planit të vendosjes.

- ***Lavaman me nënkonstruksion (me komo)***

Lavaman laboratori me nënkonstruksion me tre dyer (ndarje) me kosh mbeturinash
të inkastruar.
Përmasat: gjatësi 1500 mm; gjërësi 560 mm; lartësi 900 mm
Suprina:
Lavapjatë me një gropë lavamani me hapësirë drite nga brenda gjatësi 510 mm, gjërësi 360, thellësi 195 mm dhe me dy pjesë për tharjen e enëve (majtas e djathtas)
me përmasa totale gjatësi 1300 mm, gjërësi 560 mm.
Materiali i lavapjatës Inoksi.
Furnizimi me ujë: Një shtyllë vertikale gati 300 mm e lartë me një shkarkim prej gati



200 mm, pajisur me nga një valvul shkarkuese për ujin e ftohtë dhe ujin e ngrohtë (me bateri mikse)

Komoja:
Përmasat rreth 1500 x 500 x 860 mm; me xokolature 150 mm të lartë; ndarjet janë 180 mm më poshtë se niveli i poshtëm i suprinës; me material melamine ose MDF.
Tre dyer rrotulluese me listele mbrojtëse ndaj përplasjes.

- ***Dollap koleksioni biologjie / fizike***

Përmasat rreth 1050 x 560 x 2050 mm ose 1200 x 560 x 2050 mm
Materiali melamine ose MDF.
2 bazamente raftesh të cilëve mund tu rregullohet lartësia.
7 bazamente sirtaresh që mund të tërhiqen jashtë deri në gjysëm gjërësi (konstrukt

çeliku), me mundësi shumë të lehta për t `i hequr bazamentet për arsye demonstrimi.
Të gjithë bazamentet e sirtarëve me listelë kapëse 15 mm në të gjitha anët dhe me fuqi mbajtëse prej minimumi 600 N
2 dyer rrotulluese në dy të tretat e lartësisë mbuluar me xham me listela lëkundese dhe secila me tre mentesha
Bravë me kllapë dhe shul rrotullues me dorezë të madhe.

12. Laboratori i informatikës

- ***Tavolinë nxënësish për informatikë me 2 vende (1600 x 800 mm)***

Tavolinat e informatikës ndahen në tavolina për Deskop dhe në tavolina për Laptop
Përmasat e tavolinës për Deskop:
Gjithsej: rreth 1500 x 800 x 700 mm

Suprina: rreth 1500 x 800 x 25 mm
Skeleti: rreth 1500 x 640 x 670 mm
Hapësira e lirë: lartësia minimumi 630 mm
2 çengela që ndodhen nga brenda për të varur çantat e nxënësve
1 Kanal nën tavolinë për kalimin e kabllove dhe vendosjen e prizave
1 Prizë treshe me kabëll lidhës minimumi 1,5 m
Suprina e punës:
Pllakë melamine; veshur me lëndë plastike dhe me shirit anësore plastike; dhe që del
mbi skelet,
Skeleti:
Në formë tubi, realizuar për t’u montuar në dysheme, përbëhet nga një konstrukt me kornize I derdhur (pa ndërprerje) me këmbë metalike; këmbët metalike janë të pajisura me vidha rregullimi lartësie për të siguruar një nivel horizontal të pavarur nga mosniveli I dyshemesë.
Kanal instalimi për kabllin që sjell rrymën dhe për kabllin e rrjetit në njërën anë të gjatësisë, me kapak që mund të zhvidhoset dhe me vijë ndarëse në këtë kanal kablli.
Hyrja e kabllit bëhet sipas dëshirës në një nga dy pjesët e fundme të kutisë instaluese. Daljet e kabllit nëpërmjet të çarës për te aparaturat e ndjeshme që ndodhen mbi tavolinë.
Nën suprinë majtaj ose djathats është konstruksioni mbajtës i njësisë qëndrore e bërë me material melamine me përmasa : 500 x 250 x 600 mm.

- ***Karrige për nxënës me rregullim lartësie***

Skeleti:
Kolone vertikale me bazament me 5 këmbë të kryqëzuara, prej metali të nikeluar dhe me mbeshtetëse në dysheme me tapa me material PVC (fikse) ose me rrota.
Rregullim lartësie nga 420 mm në 600 mm me anë të një vide të tipit bosht e mbulluar për tipin me tapa PVC dhe 470 mm deri në 670mm për tipin me rrota.
Pjesa ulëse dhe mbështetëse me material kompesate e presuar.
Ngjyra sipas dëshirës së porositësit

- **Tabelë njëfaqëshe e lëvizshme**

Përmasat: rreth 2000 x 1200 mm,
Sipërfaqje prej çeliku magnet ngjitëse pa Shkëlqim

- **Specifikime UPS 1000VA**

KARAKTERISTIKA MINIMALE TEKNIKE	
DALJE “OUTPUT”	
Fuqia “Poëer”:	1000 VA
Faktori i fuqisë “Poëer Factor”:	≥0.8
Forma e valës “Ëave Form”:	Sinusoidale
Tensioni nominal “Nominal Voltage”:	220-240 VAC
Frekuenca “Frequency”:	50 Hz +/- 5%
Rregullimi i Tensionit “Volt, regul. (On battery)”:	+/-10%
Prizat dalëse “Output Connectors”:	≥ (4) IEC 320 C13 (nga bateria)
HYRJE “INPUT”	
Tensioni nominal “Nominal Voltage”:	220 - 240 VAC

Frekuenca:	50 Hz
Dritarja e tensionit “Voltage Ëindoë :	170 - 270 VAC
Rregullim automatik i Tensionit “AVR”:	Po
Prizat hyrëse “Input Connectors”:	(1) IEC 320 C14
KOMUNIKIMI & MENAXHIMI	
Programi i fikjes “Shutdoën Softëare”:	Po
Sinjalizim me dritë “Led Indicators”:	Për të gjitha gjendjet
Sinjalizim me zë “Audible Indicators”:	Për të gjitha gjendjet
Prizë për komunikimin e të dhënave “Data”:	(1) DB9 Serial ose USB
Mbrojtja ”Protection”:	Overload, Discharge, and Overcharge Protection
BATERITË	
Koha e transferimit “Transfer time”:	≤4 ms
Koha e funksionimit me bateri “Back-Up Time”:	≥6 min. me ngarkesë të plotë
Tipi i baterive “Battery Type”:	12 V DC 7 Ah Lead-acid
AKSESORËT	
Kabëll për linjën kryesore “Poëer Cord”:	(1) European IEC-C13
Kabëll për lidhjen e PC “PC Poëer Cord”:	(2) IEC 320 C13 - IEC 320 C14
Kabëll për komunikimin data “Data Cable”:	(1) DB9 Serial - DB9 Serial ose USB- USB
GARANCIA	
Periudha e mbulimit të garancisë “Ëarranty”:	2 vjet

Specifikime per Kompjutera (min. nga nje kompjuter/nxenes dhe nje kompjuter per mesuesin)

KARAKTERISTIKA MINIMALE TEKNIKE	
Pikët min. për procesorin sipas: cpu benchmark.net Min Proc. Rating according to: cpubenchmark.net:	5400
“RAM”:	4 GB, min. DDR3 1600 MHz Non-ECC
Madhësia e Hard Diskut “HDD Size”:	500 GB
Shpejtësia e Hard Diskut “Media sizes”:	7200 Rpm SATA 6.0Gb/s
“Disk subsystem controler”:	Serial ATA 6.0 Gb/s
Karta Grafike “Graphics”:	≥ 1 GB
“Media Device”:	DVD+/-RË
“Slots”:	Minimum (3) PCI/PCI-E, nga te cilat (1) x16 PCI-E.
KOMUNIKIMI & MENAXHIMI	
Porta e komunikimit “Ports”:	Min. (8) USB nga te cilat: g. min (2) USB Para h. min (2) USB 3.0 (1) RJ-45, (1) audio in/out, (1) mic. and headphone, (1) VGA.
“Netëorking”:	(1) 10/100/1000 LAN Integrated Gigabit Ethernet Port.
“Sound”:	Integrated Sound Card
“Speakers”:	Internal or Built-in Monitor
Siguria “Security Management”:	Embedded Security TPM
Sistemi i Operimit “Preinstalled Licensed O.	OEM Ëindoës 10 64-bit Professional

“Keyboard”:	Standart Keyboard QËERTY
“Mouse”:	Minimum 2 Button scroll Optical
Ushqimi “Poëer Supply”:	220 V AC, 50 Hz
AKSESORËT	
Kabëll “Poëer Cord”:	European
Recover CD :	Recover CD/DVD ose Recover Partition
MONITORI	
Tipi “Type”:	LCD OSE LED i të njëjtës markë me kompjuterin
Madhësia “Size” :	21”
Rezolucioni “Native Resolution”:	1920 x 1080 at 60 Hz
Raporti I kontratit “Constrast Ratio Static”:	1000:1
“Display Port”:	(1) VGA dhe të paktën (1) prej portave DVI/HDMI/DP
Koha e rifreskimit “Response Time”:	≤ 5 ms
Kursimi i energjisë “Energy Efficency”:	Energy Star
Ushqimi “Poëer Supply”:	220V AC, 50 Hz
GARANCIA	
Periudha e mbulimit të garancisë “Ëarranty”:	3 vjet

7. Specifikime per Laptop (min. dy laptop/ laborator)

KARAKTERISTIKA MINIMALE TEKNIKE	
Pikët min. për procesorin sipas: cpubenchmark.net	3400
“Chipset”:	Intel ose Ekuivalent
“RAM”:	8 GB shared Dual Channel min. DDR3 1600 MHz
Madhësia e Hard Diskut “HDD Size”:	500 GB
Shpejtësia e Hard Diskut “Media sizes”:	7200 Rpm SATA
“Graphics”:	Integrated Graphics ëith 1 GB video memory
“Media Device”:	DVD+/-RË ëith DL Memory Card Reader
“Diplay”:	15.6” LED display, Anti Glare
Bateria “Battery”:	min 4-cell battery
KOMUNIKIMI & MENAXHIMI	
Porta e komunikimit “Ports”:	Min (3) porta USB nga të cilat min. (1) USB 3.0 DisplayPort ose HDMI Out Integrated digital mics Integrated Ëeb Camera Headphone jack/Microphone jack

“Netëorking”:	10/100/1000 LAN (RJ 45) Ëireless 802.11 b/g/n/ac
“Sound”:	High Definition Audio2.0
Sistemi i Operimit “Preinstalled Licensed O. S.”:	OEM Ëindoës 10 64-bit Professional
“Keyboard”:	QËERTY
“Pointing Device”:	Touch pad & usb mouse
AKSESORËT	
Kabëll “Poëer Cord”:	European
Ushqyesi “Recharger”:	Po
Çantë:	Po, nga prodhuesi. E përshtatshme për Laptop dhe aksesorët e tjerë.
“Recover” dhe “Drivers”CD/DVD:	“Recover”, “Drivers” CD/DVD ose Rec. Partition
GARANCIA	
Periudha e mbulimit të garancisë “Ëarranty”:	3 vjet

8. Specifikime per Printer/scan/fotokopje

KARAKTERISTIKA MINIMALE TEKNIKE	
"Model":	print/scan/copy
Shpejtësia e printimit “Print Speed” A4:	≥18 ppm
Mirëmbajtja mujore “Monthly duty cycle”:	8000
Teknologjia “Technology”:	Laser ose LED
Razolucioni i printimit minimal “Print Quality”:	600 x 600 dpi
Kapaciteti në hyrje “Input Capacity”:	150 Fletë
Kapaciteti në dalje “Output Capacity”	50 Fletë
Formati i letrës “Media format”:	A4
Memorja “Memory”:	≥32 MB
Rezolucioni minimal optikal i skanimit "Min. optical scan resolution":	600 x 600 dpi
Sistemi i Operimit i suportuar "OS supported"	Ëindoës 7 e lart (32 bit & 64 bit)
“Toner”:	Shoqëruar me Starter Kit
KOMUNIKIMI & MENAXHIMI	
Porta e komunikimit “Interface”:	High Speed USB 2.0
Portë komunikimi “Ethernet”:	Nuk specifikohet
AKSESORËT	
Kabëll “Poëer Cord”:	European

Softëare/Drivers CD:	Po
Kabëll USB:	Po
GARANCIA	
Periudha e mbulimit të garancisë "Ëarranty":	1 vit

5.4 2.2 Hapësirat shoqërore

5.4.1 2.2.1 Biblioteka

Përdoruesit e bibliotekës janë si nxënësit ashtu edhe mësuesit prandaj në llogaritjen e hapësirave të bibliotekave duhet të merret kjo gjë parasysh.

Për shkollat e mesme ambienti i bibliotekës duhet të llogaritet duke u nisur nga numri i nxënësve dhe nga sipërfaqja e nevojshme për çdo nxënës që duhet të jetë 0,15 m².Të mendohet pjesë të arkivimit të librave dhe vende leximi për nxënësit. Te mendohet qe salla e leximit e biblotekes te kete ndricim natyral sa me shume te jete e mundur. Cdo postacion leximi te jete i pajisur me priza.

- ***Tavolinë bibliotekë (1000 mm)***

Forma katrore
Përmasat: rreth 1000 x 1000 x 720 mm
Suprina:
Përmast rreth 1000 x 1000 x 25 mm
Skeleti:
Përmasat rreth 1000 x 1000 x 690 mm
Në formë tubi – veshur me material plastik ose i kromuar me 4 bazamente rrëshqitëse prej plastike që rregullojnë lartësinë dhe kornizë në formë tubi e derdhur
(e pandërprerë).

- ***Dollap për kartelat***

Përmasat rreth 940 x 500 x 900 mm

Korpusi (trupi)
Një ndarje vertikale në mes me material melamine ose ekuivalente me të, të fiksuar lartë e poshtë me anë të vidave.
Në çdo nëndarje vertikale janë tre rafte, po me material melamine, të cilët bëjnë të mundur vendosjen e sirtarëve.
16 sirtarë për rreth 15.000 kartela të cilët mund të hiqen lehtësisht.
Materiali i sirtarëve prej druri, me vend për tu kapur e tërhequr lehtësisht.
Përmasat e sirtarëve: 210 x 210 x 480 mm

- ***Raft librash (thellësia 30 cm)***



Përmasat: rreth 900 x 320 x 2080 mm
5 dërrasa ndarëse raftesh të lëvizëshme
Sipas planskicës shoqëruese
Kokat (pjesët kryesore) janë realizuar duke pasur parasysh lidhjen e mundshme në seri sipas hapësirës.
Konstrukt me korniza që përbëhet nga pjesët kryesore që ndodhen anash dhe një bazament sirtari që ndodhet sipër dhe që është lidhur e fiksuar në lartësinë e xokolaturës.
Suprina dërrasë druri e veshur me rimeso.
4 bazamante të rrëshqitëshme prej plastike të lëvizshme për të rregulluar lartësinë.

- ***Raft për gazetat dhe revistat***

Sipas planskicës shoqëruese
Përmasat rreth 1160 x 370 x 1920 mm
Kokat e raftit janë realizuar duke pasur parasysh lidhjen e mundshme në seri sipas hapësirës.
Konstrukte kornizash që përbëhet nga pjesë kryesore vendosur anash dhe një bazament sirtari të vendosur përpara dhe të lidhur e fiksuar në lartësinë e xokolaturës.
1 pllakë e plotë që ndodhet nga prapa
Pjesë e hapur me 20 njësi
Për çdo njësi nga 1 dërrasë ndarëse raftesh e lëvizshme që rrëshqet sipas një shine me tapë që shërben për ta ndaluar e tipit PVC dhe listele kapëse PVC 35 mm e vendosur përpara.

5.4.2 2.2.2 Hapësira për shumë qëllime

Në hapësirat për shumë qëllime bëjnë pjesë ambientet, të cilat mund të përdoren për disa qëllime si p.sh salla mbledhjesh nxënës-mësues, sallë takimesh për mësues-prindër, për të zhvilluar simpoziume, për të shfaqur materiale të ndryshme filmike etj. Kjo salle te jete e projektuar ne formen e nje auditori dhe te kete kapacitet ules per te pakten 100 veta. Te mendohet nje pjese ku sherben si skene apo per leksione te vecanta duke i mundesuar shkolles te zhvilloje aktivitete me te gjera. Salla te kete sistem audio dhe dhome teknike per te komanduar ndricimin, audion, projektor etj. Te mendohet qe salla te jete akustikisht funksionale. Kjo hapesire te kete dy hyrje, nje e drejteperdrejt nga korridoret e shkolles dhe nje e lidhur ne menyre te drejtperdrejt me hapesiren publike te shkolles, qe te jete fleksibel mjaftueshem duke funksionuar edhe si e vecante jashte orareve te shkolles. Lartesia minimale e saj te jete sa dy kate klasave, pra minimumi 5.6 m dysheme –tavan.

Pajisjet per nje salle te tille multifunksionale:

- ***Projektor overhead***

Overhead projektor modeli bazë MENTOR 250
Të dhënat teknike
Projektor overhead për përdorim të përditshëm
Me llampë halogjene: 2x 24 V/250 Ë
Objektiv me 3 lente me f = 315 mm
Karkasë robuste
Përdorim i thjeshtë
Inklusiv ndërruesin e shpejtë të llampës, lente jo të gërvishtme të markës
Fresnel, Ventilator, Siguresë termike , 5 m kabëll rrjeti.
Pesha: 13 kg
Përmasat: L 34 x B 36,5 x H 70 cm
Sipërfaqja e punës 285 x 285 mm
Qartësia: rreth 2.200 ANSI-Lumen
Në figurën e mëposhtme paraqitet një projektor me dia film i markës MENTOR 250, rekomandohet përdorimi I tyre ose I një marke të ngjashme që plotëson të njëjtat kushte

- ***Projektor me dia film***

Më poshtë paraqiten dy tipe të ndryshëm të projektorëve me dia film, një i ri me pult komandimi në distancë dhe tjetri me komandim me pult të lidhur me kabëll.
Të dhënat teknike të tipit **OPLITE 7**
1 x Projektor
SHËRBIMET ARKITEKTURALE / INXHINIERIKE PËR PËRPUNIMIN E SPECIFIKIMEVE TË MATERIALEVE TË NDËRTIMIT DHE SPECIFIKIMET E PAJISJEVE DHE
MOBILJEVE TË SHKOLLAVE
MINISTRIA E ARSIMIT DHE E SHKENCES SPECIFIKIMET E MOBILJEVE DHE PAJISJEVE LABORATORIKE Faqe -66-
2 x Lampa 400Ë - 36V
1 x Çantë për transportimin e saj
1 x 3280 Magazin për dia film
1 x Objektiv zmadhues 70-120 mm (1:2,8)
1 x kabël për komandim në distancë
1 x Pult komandimi me 6 funsione të tipit IFR 8
Në figurën e mëposhtme paraqitet një projektor me dia film i markës SIMDA, rekomandohet përdorimi i tyre ose i një marke të ngjashme që plotëson të njëjtat kushte
Të dhënat teknike të tipit **OPLITE 4**
1 x Projektor
2 x Lampa 250Ë - 24V
1 x Çantë për transportim
1 x 3280 Magazin për dia film
1 x Objektiv zmadhues 85-150 mm
1 x kabëll për komandim në distancë
Rregullim fokusi + / -
Në figurën e mëposhtme paraqitet një projektor me dia film I markës

SIMDA, rekomandohet përdorimi I tyre ose I një marke të ngjashme që plotëson të njëjtat kushte

- ***Tavolinë pune për dhomën e konferencave***

Përmasat: rreth 1950 x 975 x 720 mm.
Suprina: Përmasat: rreth 1950 x 975 x 30 mm. Materiali pllakë melamine ose ekuivalente me të, me veshje plastike dhe shirit plastik për bordurën.

Skeleti: Përmasat: rreth 1950 x 975 x 685 mm Materiali tub metalik me katër këmbë që mbështeten në dyshemë dhe janë të pajisura me vida rregulluese lartësie me material PVC.

8.3 Dhoma e komunikimit (IT Room)

- ***Specifikime Pajisje Rrjeti***

Dhoma e IT duhet te kete specifikat si me poshte:

- Permasat e dhomes te jene minimalisht 2 m x 2 m (4 m2).
- Shenim: *Nqs do te planifikohet qe shkolla te kete Pajisje server duhet te kete system kondicionimi ku temperature standarte te jete 21 Grade konstante.*
- Ne dhomen e serverit te kete Kabinet pajisjesh (rack) per kabllim minimalisht 24 HU.
- Minimalisht nje UPS 1000VA per pajisjet e rrjeit si sëitch, router ëireless etj.
- Patch-panel 24 Port per cabinet (rack) ne varesi te lidhjeve qe duhen per poste pune
- Sëitch-e Layer 2 per shperndarje te rrjetit
- Router Ëireless per shperndarje te signalit te internetit ne vendet ku do te cakohet te kete internet.
- Patch-Cord 1 m ose 2 m, Cat6(per lidhjet midis sëitche-ve dhe patch paneleve)
- Priza Rack 6-tshe me sigurese per Kabinetin(rack

- Sëitch me 5 Porta

KARAKTERISTIKA MINIMALE TEKNIKE	
Tipi, "Type":	Sëitch Gigabit i pamenaxhueshem 5 Porta
Numri i portave Ethernet "Number of Ethernet Ports" :	5 Porta Gigabit
Menyrat e forëard-im, "Forëarding modes":	Store-and-forëard
Protokollet e rrjetit IEEE, "IEEE Netëork Protocols":	IEEE 802.3 Ethernet IEEE 802.3ab 1000BASE-T

Certifikimi i produktit,	CE mark
Aksesoret e perfshire, "Accessories included":	Poëer Supply Poëer Adapter Quick Install
Periudha e mbulimit të garancisë “Ëarranty”:	1 vit

- Sëitch me 8 Porta

KARAKTERISTIKA MINIMALE	
Tipi, "Type":	Sëitch Gigabit i pamenaxhueshem 8 Porta
Numri i portave Ethernet "Number of Ethernet Ports" :	8 Porta Gigabit
Menyrat e forëard-im, "Forëarding modes":	Store-and-forëard
Protokollet e rrjetit IEEE, "IEEE Netëork Protocols":	IEEE 802.3 Ethernet IEEE 802.3ab 1000BASE-T
Certifikimi i produktit, "Certification":	CE mark
Aksesoret e përfshirë, "Accessories included":	Poëer Supply Poëer Adapter Quick Install
Periudha e mbulimit të garancisë	1 vit

- Sëitch me 24 Porta

KARAKTERISTIKA MINIMALE TEKNIKE	
Ndërfaqet dhe Karakteristikat HË	Sëitch 24 Port L2
Porta PoE 10/100/1000Mbps RJ45 (Auto Negocim /Auto MDI/MDIX)	≥24
Porta uplink (bakër/fibër) 100/1000Mbps SFP Slots	min. 2 Combo Opsionale
Porta Combo	Opsionale
Porta Console RJ45/RS232	1
Instalimi në rack	19” rack mountable
HYRJE "INPUT"	
Tensioni Nominal	100~240VAC
Frekuenca	50/60Hz
PERFORMANCA DHE	

Bandëitdth/Backplan	≥ 48 Gbps
Throughput	≥35 Mpps
Jumbo Frame	Opsionale
Tabelë të Adresave MAC	16k
Fan	Opsionale
STANDARDET	
IEEE 802.3 - 10BASE-T	Po
IEEE 802.3u - 100BASE-T	Po
IEEE 802.3ab -1000BASE-T	Po
IEEE802.3z -1000BASE-X	Po
IEEE 802.3ad - Agregim linku	Po
IEEE 802.3x -full duplex on 10BASE-T, 100BASE-TX, and	Po
IEEE 802.1d -Spanning Tree Protocol	Po
IEEE 802.1s- multi STP	Po
IEEE 802.1ë- RSTP	Po
IEEE 802.1q -VLAN	Po
IEEE 802.1x - Port-based Netëork Access Control	Po
IEEE 802.1p -QoS classification	Opsionale
IEEE 802.3at	Po
IEEE 802.3af- PoE	Po
SISTEMI OPERATIV	
Të jetë i orjentuar për operacionet LAN	Po
Të ketë mundësi për upgrade	Po
QUALITY OF SERVICE	
Priority queues	Po
Queue scheduling	SP, ËRR
Vecoritë në Layer 2 dhe 3	
IGMP Snooping	V1/V2/V3
Spanning Tree	STP/RSTP/MSTP
LLDP	Po
BPDU Filtering/Guard	Po
Detektim të Loopback	Po
802.3x Floë Control	Po
VLAN	4k, (Voice VLAN Opsional)
Agregim të linkeve	802.3ad LACP
Adresimi IPv6	Po

DHCP/BOOTP, DHCP Snooping, DHCP Option82 per klientët	Po
Dynamic ARP inspection (DAI)	Po
Kufizim të shpejtësisë	Port/Floë
Policy-based routing (PBR)	Jo
Routimi	Jo
SIGURIA	
Access Control List	min L2
TCP/UDP Ports	Po
Protokollin DSCP	Po
Authentication	TACACS+ , RADIUS, IEEE 802.1X, Port/MAC, SSH v1/v2, SSLv2/v3/TLSv1
Storm Control	broadcast, multicast, unicast
MENAXHIMI	
Ëeb-based GUI dhe CLI.	Po
RS-232 console/ RJ45 Console	Po
Telnet, SSH	Po
Monitorim te CPU	Po
SNTP	Po
Upgrade të Firmëare	TFTP ose nderfaqes Ëeb
Ekran Led	Opsionale
SNMP v1/v2c/v3	Po
SYSLOG	Po
Garancia	1 vit

Router Ëireless

KARAKTERISTIKA MINIMALE TEKNIKE	
Tipi, "Type":	Router Ëireless Ëi-Fi Gigabit
Mënyrat e Operimit, "Operation Mode":	Ëireless router mode Access point mode Media bridge mode
Rating:	Min AC 1900
Standartet ËiFi, "ËiFi standards":	IEEE 802.11a/b/g/n/ac
Standardet e Rrjetit, "Netëork Standart":	IEEE 802.11a, IEEE 802.11b, IEEE 802.11g, IEEE 802.11n, IE EE 802.11ac, IPv4, IPv6
Portat, "Ports":	(1) Gigabit ËAN Port (4) Gigabit LAN Ports (1) USB 3.0

Lloji i lidhjes ËAN, "ËAN Connection Type":	Automatic IP, Static IP, PPPoE (MPPE supported), PPTP, L2TP
Niveli i Transferimit, "Transfer rate" :	deri në 1.3 Gbps
Protokollet e Rutimit, "Routing protocols":	IPSec, L2TP or PPTP
Banda e Operimit, "Band":	Dual band: 2.4 GHz & 5 GHz
Antenat, "Antennas":	Build-in or external
Siguria, "Security features":	ËEP 64/128-bit ËPA2-Personal & Enterpise (AES/TKIP) ËPS
Drita LED, "LED indicators":	Yes
Butona, "Buttons":	ËPS Button Reset Button Poëer Button
Kerkesat e Sistemit te Operimit, "System requirements": **Ushqimi, "Poëer Supply":**	Ëindoës 7, 8 ose 10 AC Input: 110V ~ 240 V (50 ~ 60Hz)
Aksesoret , "Accessories included":	Quick start guide CD-ROM ëith documentation External Antennas (opsional) Ethernet cable Poëer Adapter Poëer Cord
Periudha e mbulimit të garancisë	4 vit

5.4.3 2.2.3 Salla për edukimin fizik

Shkollat e mesme

Në shkollat e mesme duhet patjetër të ketë një ambient të veçantë të mbyllur (palestër) për edukimin fizik si dhe ambientet në oborrin e jashtëm të saj. Përmasat minimale për palestrën duhet të jenë të tilla që në këtë ambient të luhet basketboll dhe volejboll pra 18 m x 26 m.Lartesia minimale e saj te jete sa dy kate, pra minimumi 5.6 m dysheme –tavan.

Përveç kësaj salla e edukatës fizike duhet të ketë ambientet e veta ndihmëse:

- dy garderoba me madhësi minimumi 20 m² secili.
- dy banjo – dushe minimumi 20 m²
- një depo për veglat minimumi 20 – 30 m²
- ambient për mësues me banjo – dush dhe garderobë minimumi 16 m²

Palestra duhet te jene e parashikuar per shtrim me parket druri me binare dhe e vijezuar per zhvillimin e volejboll/ basketboll ne te.
Gjithashtu palestra dueht te kete suportet per vendosjen e rrjetave te volejbollit dhe koshat dhe tabelat e basketbollit.

Elemente te nevojshme per palestren:

- Portmanto per dhomen e mesuesve
- Varese rrobash (per palester)
- Stola te gjate
- Kosha basketbolli per ambjente te brendshme
- Shkalle suedeze dyshe 2x(1mx220 m)
- Dyshek gjimnastike
- Rrjeta volejbolli

5.5 2.3 Hapësirat administrative

5.5.1 Per secilin tip shkolle te parashikuar, me poshte jane evidentuar numri I stafit akademik dhe administrues:

Numri I stafit te nevojshem

Shkolla sipas numrit te klasave	Nr. Nx	Nr Klasave	Mesues	Drejtor	Nendrejtor	Sekretar	Psikolog	Punjes Social	Roje	Punetore pastrimi	Mjek/Infermier
Shkolle 9-vjecare me 20 klasa, me 30nx/klase	600	20	26	1	1	0	1	1	1	3	1
Shkolle 9-vjecare me 30 klasa, me 30nx/klase	900	30	40	1	2	0	1	1	1	3	1
Shkolle 9-vjecare me 20 klasa, me 24nx/klase	480	20	26	1	1	0	1	1	1	3	1
Shkolle e mesme e larte me 21 klasa, me 30nx/klase	630	21	32	1	1	1	1	1	1	3	1

5.5.2 2.3.1 Zyra e drejtorit / Zyra e nëndrejtorit

Zyra e drejtorit dhe e nendretoreve te jene te shperndara ne cdo kat, ne kete menyre rritet kontrolli i shkolles.
Zyra e drejtorit në shkollat e mesme duhet të jetë minimumi 25 m²
Zyra e nëndrejtorit në shkollat e mesme duhet të jetë minimumi 16 m²

Tavolina: Përmasat rreth 3700 x 1020 x 720 mm

Suprina Përmasat rreth 1950 x 975 x 50 mm Melamine e rimesuar me ristele druri natyror

Skeleti

Suprina mbështet mbi dy këmbë të cilat janë me diametër 500 mm, me material dru masiv i lyer me llak natyral.

5.5.3

5.5.4 2.3.2 Sekretariati / dhoma për administratën

Në këto shkolla është e nevojshme të ketë një sekretari. Hapësira për sekretarinë të jetë minimumi 16 m². Preferohet te jete e pozicionuar ne katin 0.

- Dollap për regjistrat

Përmasat rreth 1260 x 450 x 2080 mm

Materiali i korpusit dhe i nënndarjeve: Pllakë melamine – me shtresë veshjeje plastike me shirit veshës plastik të bordurave.

Ndarjet realizuar duke pasur parasysh lidhjën e mundshme në seri sipas hapësirës dhe shfrytëzimin sa më mirë të saj.

1 ndarje e pandërprerë vertikale

2 ndarëse raftesh të fiksuara, në gjysëm gjërësi

2 ndarëse raftesh të cilave mund ti rregullohet lartësia, në gjysëm gjerësi

1 kornizë te shinat teleskopike (udhëzuese) që mund të hiqet me shtesë (arkë e vogël) për fletët e inventarit dhe kontove – tërthorazi (madhësia e fletës 380 x 260 mm) në gjysëm gjerësi.

4 korniza që tërhiqen mbi shinat e teleskopit (udhëzuese) për arkivin e regjistrave me përmasa A4 – në gjysëm gjerësi.

2 dyer rrotulluese bravë me lloz dhe shtizë rrotulluese me dorezë cilindrike dhe cilindër të madh përshtatur në sistemin e përgjithshëm të mbylljes.
5.5.5

5.5.6 2.3.3 Salla e mësuesve

Hapësira për sallat e mësuesve në shkollat e mesme duhet parashikuar 2,5 m² për çdo mësues. Nese kemi disa salla mesuesisht eshte e preferueshme te jene ne kate te ndryshme



- Tavolinë takimi

Përmasat rreth 3700 x 1020 x 720 mm
Suprina Përmasat rreth 1950 x 975 x 50 mm



Melamine e rimesuar me ristele druri natyror

Skeleti
Suprina mbështet mbi dy këmbë të cilat janë me diametër 500 mm, me material dru masiv i lyer me llak natyral.

5.5.7 2.3.4 Personeli ndihmës

Për personelin ndihmës, ku përfshihen personeli mirëmbajtes, duhet të parashikohet një ambient me hapësirë prej 2 m² për çdo person.

5.6 2.4 Hapësirat ndihmëse

5.6.1 2.4.1 Ambjentet higjeno-sanitare

Sanitaret, mësues, nxënës, meshkuj/femra

Blloku sanitar qe perfshin tualetet duhet te jete ne cdo kat.

Vendndodhja
Klasat e mësimit dhe të pushimit nuk duhet të vendosen më larg se 50 m nga sanitarët.
Numri
Në përcaktimin e numrit të ËC-ve duhet të bazohemi në normat që janë paraqitur në tabelën e mëposhtme, e cila shërben për të gjitha kategoritë e shkollave.

	Nr. i nxënësve/ mësuesve	ËC kabina	Pisuarë	Lavamane
Meshkujt				
Nxënësit (djem)	Rreth 100	2	4	2
Mësuesit	Rreth 20	2	2	1
Femrat				
Nxënëset (vajza)	Rreth 100	4	Njëra ËC me bide	2
Mësueset	Rreth 20	2	Njëra ËC me bide	1
Dhoma për mirëmbajtje	2 m² për çdo kat			

Nuk eshte e rekomandueshme qe tualetet e mesueve dhe nxenesve te jene te ndara. Keshtu qe te parashikohet qe te ndajne te njejten hapesire sherbimi, korridori, lavamane etj.

Për të shmangur erërat shqetësuese, duhet ushtruar një kujdes i vazhdueshëm për paisjet sanitare.
Për më tej rekomandohet :

- Muret të jenë rezistente ndaj gërvishtjeve, mundësisht të mos pranojnë shkrimin mbi të, pra të vishen me pllaka majolike deri në lartësinë minimumi 1,6 m.
- Dyert e nyjeve të ËC-ve duhen të jenë 70 cm dhe të hapshme nga jashtë.
- Në pisuare duhet të ketë ujë të bollshëm dhe të rrjedhshëm për shmangien e erërave shqetësuese.
- Minimumi i dimensioneve të një nyje ËC-je duhet të jetë jo me të vogla se 1,3 m x 0,9 me lartësi minimale 2 m
- Sanitaret duhet të jenë të hidroizoluara dhe të kenë ventilim të mirë.
- Për larjen e ambientëve të ËC-ve duhet që të parashikohet një rubinet ku mund të lidhet një tub llastiku si dhe një piletë për mbledhjen e ujrave. Në paradhomat e grupeve më të mëdha sanitare duhet parashikuar dhe një piletë për largimin e ujerave të dyshemesë.

Sanitaret, për persona më aftësi të kufizuar
Për të gjitha kategoritë e shkollave duhet të ketë minimumi një nyje ËC-je për këta persona. Për informacione të mëtejshme referojuni VKM 1503, datë 19.11.2008, “Për personat me aftësi të kufizuara”..
5.6.2

5.6.3 2.4.2 Kabineti i mjekut

Kabineti i mjekut vendoset në katin e perdhe të ndërtesës dhe ka një sipërfaqe 17-18m², me dimensione të këshillueshme 6x3m. Gjatësia 6m është e nevojshme për kryerjen e rregullt të ekzaminimeve për pamjen dhe ndigjimin tek nxënësit.
Në kabinet duhet të ketë një larëse duarsh.
Ndricimi natyral të sigurohet me një hapje dritaresh me sipërfaqe sa 1/6 e sipërfaqes së kabinetit. Ndricimi artificial të jetë 100 lux.

- **Dollap për instrumenta mjeksore**

Përmasat rreth 1260 x 550 x 2080 mm
Materiali i korpusit dhe i nënndarjeve:
